

## INTERVISTË ME AJNISHAHE AZEMIN

Prishtinë | Data: 20 tetor, 2020

Kohëzgjatja: 170 minuta

Të pranishëm:

1. Ajnishahe Azemi (e Intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zonja Ajnishahe, nëse mundeni me jep ni prezantim për veten, ni biografi të vogël edhe diçka për familjen e juv të parë.

**Ajnishahe Azemi:** Unë jam Ajnishahe Azemi, nga fshati Loxhë i komunës së Pejës. E njohur si politikane, ai antare dhe aktiviste e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Forumit të Gruas të Lidhjes Demokratike të Kosovës që nga themelimi. Aktiviste e çështjes së aftësisë së kufizuar, aktiviste e çështjeve humanitare. Punën në gjimnazin “Xhevdet Doda” për dyzetë vite, prej vitit 1980 deri më 1. 8. 2020. Pastaj angazhimi në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në vitin, në fillim të vitit 1998 deri në përfundim. Pastaj është angazhimi institucional, kam qenë për 15 vite këshilltare e Asamblesë Komonale të Prishtinës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, domethonë prej 2002 deri 2017, katër mandate ishin. E kështu me radhë edhe aktivitete e angazhime të tjera.

**Anita Susuri:** Diçka për familjen e juv, për fëmijërinë si e kujtoni?

**Ajnishahe Azemi:** Unë para se të filloj të përgjegjem në pytyen tuaj, kisha dashtë t’i falënderoj familjen time, bashkëshortin tim, fëmijët e mi, Norën, Ilirin, Gencin, për kontributin që e kanë dhënë ata që unë të jem me të gjitha këto aktivitete.

**Anita Susuri:** Po...

**Ajnishahe Azemi:** Jetojmë në Prishtinë, në Lagjen Kodra e Trimave, tash përballë parkut të Arbërisë, si familje. Para tri vitesh na është bashkangjtit familjes tonë një zonjë e mrekullueshme, nusja e djalit të madh.

**Anita Susuri:** Po kthehemi te familja...

**Ajnishahe Azemi:** Të lutem nëse ka mundësi të vazhdoj?

**Anita Susuri:** Po, po.

**Ajnishahe Azemi:** Jam mirënjohëse gjithë atyre që më kanë përkrahë në aktivitetin tim. Bashkëveprimtarëve dhe bashkëveprimtareve, të afërmëve të tjerë, dajëve, që shkollimin atje e kom

kry, shkollimin e mesëm. Pastaj e falënderoj edhe tezën time edhe bashkëshortin e saj që këtu në Prishtinë kur ne s'kishim mundësi si studentë të financohemi, na ishim te ata, kur ata s'kishin as për veti kafshatën e gojës. Bashkëshorti i saj ishte edhe kushëri i parë i imi dhe i burgosun politik dhe të gjithë të tjerët që kanë kontribu, që me vjen keq që nuk mbërri, nuk më kujtohet, apo nuk mund t'i përmend tash, i falënderoj për përkrahjen që më kanë dhënë.

Unë kam lindë... në pytjen tuaj po përgjigjem tash, në fshatin Loxhë, me 1. 8. 1955. Kom lind me një familje të madhe, 46 antarëshe, kom lindë në një familje e cila ka pasë rend, ka pasë rregull, ka pasë respekt, çdonjëri ndaj tjetrit. Një familje çdokush që i ka ditë përgjegjësitë dhe obligimet e tyre dhe të veta. Një familje që shkollimin e ka fillu edhe te mashkujt edhe te femrat shumë herët, që është e njohur për këtë si familje. Kam lindë në një familje ku edhe odën e burrave e shfrytëzoni për të biseduar me miqtë apo dashamirët, me të afërmit e tjerë tu u tubu.

Në rast kur atëherë organizoheshin Darka e Lamës, organizoheshin, thuhej atëhere, po e them me ato fjalët si thuheshin atëherë, të djelat, që na dilshim në bjeshkë edhe kur ktheheshim si shenjë respekti ndaj asaj që na janë kthyer antarët që kanë qenë të familjes prej atje tuboheshim. Pastaj darkat e pastërmave, gazmendet e ndryshme për kanagjegje, dasma e tjerë. I përmendi këto se ishin ato do kohë, e bisedohej se si t'i rezistojnë gjendjes së kohës së atëhershme, se si faktikisht ta përkrahim familjen, se si t'i përkrahim fëmijtë, se si ta përkrahim në përgjithësi gruan.

**Anita Susuri:** Deshta m'u ndal... se po ju ndërprej, deshta m'u ndal pak ma shumë te këto Darka e Lamës, se osht' shumë interesante, është si festë kur është kry korrija...

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Më duket...

**Ajnishahe Azemi:** Po {pohon me kokë}.

**Anita Susuri:** A mundeni me na spjegu pak ma shumë, për dikun që nuk e din, si janë organizu këto, si është organizu familja, shoqnia?

**Ajnishahe Azemi:** Po ato kanë qenë, ju e thatë edhe vet se ato Darkat e Lamës ishin si rezultat i përfundimit të punimeve, meqenëse ata për sigurimin e ekzistencës merreshin me punimet e fushës. Ju thashë që dilnim në bjeshkë, atje normalisht për të mirën e shëndetit të familjarëve të vet. Edhe faktikisht ishte ajo mënyrë që ju thash pak ma parë, me qëllim të tubimit për të bashkëbiseduar për çështje me interes për familjen, për gjendjen e kohës së atëhershme e për të tjera shfrytëzoheshin ato.

Familje, kom lindë thjesht [në një familje] që ka qenë tolerante, që i ka respektuar të gjithë, ka dëgjuar mendimin e tjetrit, ka dëgju edhe mendimin e fëmisë edhe të femrës e gjithë të tjerëve. Është bisedu qysh në atë kohë se si na mundemi me ndihmu... në ato oda atje... si mundemi me ndihmu gjendjen e kombit për t'i kalu këto vështirësi dhe për t'u emancipu ma tepër dhe kanë ardhë në një përfundim, qysh herët, që thash, që t'i shkollojnë djemtë edhe vajzat. Prej asaj familje qysh '53-tën na kemi djem

që e kanë përfundu gjimnazin në atë kohë të Pejës, domethonë e ka përfundu, llogarite kur ka fillu shkollën fillore, kur është kry, shkollën e mesme katër vjet, '53-tën me kry. Po edhe femrat domethonë, aty osht' dikun rreth të '50-tave që ka fillu shkollimi.

Në atë familje ashtu kemi jetu dej dikun ka klasa e tretë e shkollës fillore, meqenëse pastaj aty ishim familje, baba jetonte me vëllezërit e vet, familjet e veta. Pastaj djemtë e axhës babës dhe u rrit numri dhe në pamundësi për ni komoditet ma të mirë u desht domethonë që na të kalojmë me babë e me axhallarë në një shtëpi tjetër, në periferi të fshatit Loxhë, atje në sërabisht i thojnë Bërzhenik dhe në shqipe Lajthishtë. Edhe e theksova edhe atë emër edhe këtë se ishte problem nëse e përmendëshe emrin Bërzhenik kritikoheshë, për atë se e ka emrin Lajthishte andaj ti duhesh ta flasish gjuhën tande.

Prindërit e mi, baba jem ka qenë një njeri i urtë, një njeri i mençur, një njeri i njohur për tolerancë. Nji arsimdashës i madh, një njeri që e ka respektu femrën shumë. Nana ime tregonte se, "Kurrë në jetën time nuk e kom pasë ndonjiherë një nënçmim të fjalës time apo të punës time, por të kundërtën, e ka ndëgju fjalën time, më ka respektu". Më lejoni të theksoj diçka, ajo që gjithmonë më bon, ndoshta ka qenë edhe një motiv përpos asaj edukimi që ata ma kanë dhënë në përgjithësi, ka qenë edhe një motiv që në këto aktivitete të jam kur e kreu shkollën fillore dhe normalisht ai [babai] ishte krejt tu më përcjell se çfarë në radio, na kish ble qysh me kohë radion për shkak se me mujt me ndëgju diçka ma tepër e tjera.

Na lejonte odën me shfrytëzu për mësim, për krejt tjera, në njëfarë mënyre e kemi pasë edhe si bibliotekë (buzëqesh) edhe odën për me mësu. Edhe tu më përcjell se çka po lexoj, a po i lexoj vetëm librat e shkollës apo lexoj edhe diçka tjetër. Edhe më ka përcjell se ndonjiherë, ndonjë prej librave e kom mbështjellë, sepse ato ishin libra të ndaluar, prandaj ishin të mbështjella, jo që frigohehim prej familjes. Po unë atë e merrsha në çantë ndoshta edhe aty edhe aty, që me mujt edhe me ja tregu shokut, shoqes, bashkëmoshatarëve të mi edhe thojsha, "Mos po e harroj dikun", edhe pastaj nuk je në problem vetëm ti po edhe familja.

**Anita Susuri:** Po.

**Ajnishahe Azemi:** Dhe ai më thirri kur ishte koha e regjistrimit në shkollën e mesme, me bisedu, tha, "Isha... deshta me të pyt diçka. Jom i bindun se ti sigurisht don me u shkollu. Për cilën gjo e din ti që edhe unë jam, kam qenë edhe jam për arsimimin edhe të femrës. Por..." tha, "i kom dy kushte, nëse mundesh me m'i plotësu se përndryshe" tha, "nuk ta kisha bo hallall përkrahjen". Edhe unë u ndala po e dëgjoj, "Babë, cili osht' ai kusht?" Tha, "Kushti është që, një, mos ta ndërpresësh shkollimin së paku pa e bërë edhe fakultetin, se ka nevoj për një ngritje intelektuale të femrës ma të madhe. Kushti tjetër është që, qet' dije që e merr jo me shfrytëzu vetëm për me gjetë ni vend pune, por atë dije me shfrytëzu, faktikisht edhe për shtetin, për popllin sepse kjo gjendje nuk mund të durohet gjithmonë. Besom që Kosova duhet të shkoj një rrugë tjetër" ashtu e qunte ai, "Një rrugë që duhet me qenë vetëm. Duhet me qenë një shtet i cili faktikisht udhëhiqet nga vet qytetarët e saj, nga poplli shqiptarë".

Unë i thashë, "Babë, a ta merr menja se unë muj m'i plotësu këto dy kushte?" Tha, "Po". "Mbas çkafit?" Që ju thashë pak më parë se ai më përcjelli, jo për diçka tjetër po ndoshta kish qenë tu u kënaq që unë

po e dëgjoj Radio Televizionin Shqiptarë atje, po lexoj ato libra e tjerë. Se veç osht' ai qysh me thonë ni përpjekje e imja për të formësu një ideal për t'i kontribuar kombit. Edhe tha, "Po" tha, "se unë po e dëgjoj këtë, këtë, edhe këto tjerat" tha, "Dhe janë ato që mendoj se ti i ke. Dhe unë do të përkrahi" tha, "Faktikisht me tonë mundësitë e mia që i kom, nuk do të mungoj përkrahja ime".

**Anita Susuri:** Deshta me ju pyt edhe diçka për babën e juj.

**Ajnishahe Azemi:** Po, patjetër.

**Anita Susuri:** A ka qenë gjatë Luftës së Dytë Botërore në ndonji lëvizje ai, apo?

**Ajnishahe Azemi:** Jo.

**Anita Susuri:** Jo?

**Ajnishahe Azemi:** Jo, jo, nuk ka qenë. Ju thashë familja jonë ka qenë e njohur si familje që ka kontribu në këtë drejtim, po në format tjera. Jo {mohon me kokë}, jo në kyçjen direkte.

**Anita Susuri:** Edhe deshta me ju pyt për librat, cilat kanë qenë ato librat që i keni lexu, që kanë qenë të ndalume edhe...

**Ajnishahe Azemi:** Për shembull, "Gjarpinjtë e gjakut" të Adem Demaçit e disa tjera qishtu me rradhë, qe tash nashta pak më kanë ikë prej mendje, po janë ato që praktikisht... Ka qenë karakteristike se edhe nanën e kemi pasë punëtore të madhe. Ka qenë një gru e meçme, ni gru e fortë, ni gru e zoja, ni gru punëtore e madhe, ni gru që siçë thotë poplli, me anë të durve na ka shkollu. Me punë dore, përkundër punëve që i ka pasë të shtëpisë, krynte njikohësisht punë të shumta. Punët e shtëpisë siç e do rendi, se meqenëse tash kalum në një familje vetëm me axhallarë si zonjë e shtëpisë. Pastaj punët e fushës që u dashtë me punu, se familja jonë në atë kohë jetonte me të ardhura që i nxirrte nga punimi i fushës, nga blegtoria e kështu me radhë. Pastaj punonte edhe punë dore si qylyma, çanta të ndryshme e tjera.

Po në këtë drejtim, nuk na ka pengu ndonjiherë kur na ka pa se kemi me mësu, se do të duhej të ndihmojmë me punë shtëpie apo punëdore. Mirëpo, me thonë të drejtën edhe unë edhe motra kemi fillu qysh të reja të punojmë punëdore, punë fushe, t'i ndihmojmë familjes kur ata kanë pasë nevoj. Se na ishim... motra e madhe e ka të kryme... se ajo tash ka vdek, 78 vjeçare, para sa vjete. Edhe në atë kohë ajo ka shku vetëm në një, në katër vitet e para, ka qenë nshanëse e shkëlqyshme, e ka kry shkollën fillore. Mirëpo, rrethanat e kohës dhe pamundësia, meqenëse shkollë fillore nuk ka pasë në fshat u deshtë me shku në një fshat tjetër. Edhe ka qenë fshtirë me shku, se s'ka pasë me kan. Faktikisht edhe ndoshta rrethanat e kohës, që në atë kohën e saj nuk e ka pasë njoft shkollimin e femrës. Edhe na i kemi ndihmu nanës qysh të reja, me fillu me punu, me ndihmu punëdore.

Unë vet kom fillu me punu punëdore ndoshta prej klasës tretë fillore, për shembull për thurrjen e çorapave apo ndonji bluze çka kom mujt në atë kohë. Tash llogarit ni fëmi i asaj kohe, po ishin nevojat

e tilla. Pastaj qysh prej klasës faktikisht shtatë, sa e kom kry klasën e shtatë të shkollës fillore kam qenë ndoshta hala pa i bo trembëdhjetë vjet, ajo ishte e zanun shumë me punë dhe për ta siguru me ble libra e gjana tjera kish fillu me pregaditë qylym, i thojshin asaj {përshkruan me duar} mbulesë. Edhe ate faktikisht e punoj, po shumë kohë të gjatë s’kishte mundësi edhe e shihsha me përpjekje që po vazhdon me punu. Edhe ka qenë njerka e babës, një zojë plakë aty (buzëqesh) më mësoi qysh me bo edhe fillova e mësova, se e disha që s’më len, thotë, “E re edhe po i hup mësimet”. Fillova të mësoj edhe e kom kuptu, domethonë prej atëherë kom fillu me punu. Qe me motrën edhe kështu, kemi kriju mundësinë që të shkollohemi, vëllau, motra që është më e vogël se unë edhe unë pastaj.

**Anita Susuri:** Sa fëmijë jeni ju në familje?

**Ajnishahe Azemi:** Katër kemi qenë. Tash motra e madhe ndjesë pastë, ajo ka vdekë, tre kemi mbetë, një vëlla e dy motra. Vëllau e ka të përfunduar shkollën e lartë komerciale në Pejë, ka fillu në Fakultetin Ekonomik këtu në Prishtinë. Mirëpo i erdh ftesa për shërbim ushtarak dhe kur u kthy vazhdoi me shkollën komerciale se i pranoheshin disa prej provimeve të fakultetit ekonomik. Edhe me qëllim që edhe ai ta përkrah familjen e të vij deri te vendi i punës (buzëqesh), u mundua që ma shpejt të vijë ajo mundësi dhe e përfundoi Shkollën e Lartë. Unë siç ju thash e kam të kryer Fakultetin Filozofik, kurse e trajnime e tjera, tjera, ato janë diçka tjetër. Po motra ime e ka të kryer edhe masterin e juridikut është kryetare e Gjykatës për Kundërvajtje në Dragash, se atje është e martuar.

**Anita Susuri:** Kur e keni vazhdu shkollimin e mesëm, si keni marrë vendim me shku atje edhe a ka qenë vështirë? Me siguri në Pejë e keni vazhdu?

**Ajnishahe Azemi:** Unë ju thashë ma parë jo në Pejë, se që i falënderova dajët. Për arsye se prej fshatit tonë...

**Anita Susuri:** Në Prishtinë?

**Ajnishahe Azemi:** Po. Prej fshatit e kam kry në gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan dhe kom banu te dajët në fshatin Isniq se aty ka qenë ma afër. Këtu prej Loxhës unë isha e interesime me shku në gjimnaz, në atë kohë gjimnazi “11 Maji” (buzëqesh), tani “Bedri Pejani”, ishte shumë larg, gati te Gryka e Rugovës atje. Me shku prej fshatit Loxhë nëse e kishë ndërrimin e paraditës dimrit u deshke nëpër terr m’u nis, edhe unë si të shkoj atje prej fshatit se s’kisha me kon. E te dajët shkova atje kom nejt gjatë shkollës së mesme për arsye se në të dy ndërrimet kam pasë fatin... aty ka qenë një familje që kanë jetu edhe vëllezërit e nanës edhe axhallarët e nanës me familjet e tyre, me djemtë e tyre.

Kom pasë fatin që aty paradite kanë punu djali axhës nanës, atje ni punë në bibliotekë në Deçan. Edhe daja ka pasë, vëllau i nanës Aliu ka qenë i burgosun politik që e ka pasë të kryer në atë kohë edhe shkollën e mesme që tham atëherë në atë kohë në Pejë gjimnazin real. Mirëpo, është burgosë për aktivitet politik dhe i ka mbajtë gjashtë vjet burg në Idrizovë dhe ja kanë marrë të drejtën e shkollimit dhe ai e ka pasë hap... kur ka ardhë këtu e ka pasë marr ni zanat për punimin e dritareve dhe dyrve dhe punonte. E ka pasë hap ni punëtori për më mbajtë familjen në Deçan.

Dhe në momentin kur ndoshta nuk kisha shoqe dhe shokë për m'u kthy, me shku në shkollë, si m'u kthy kur ndonjiherë na qëllonte që me pasë ni orë ma shumë ata apo une, e tjetër, ai më pritke edhe unë bashkë me të kthehesha. Prandaj edhe këto kanë qenë ato që më kanë shty mu me shku atje. E kom pasë ni përkrahje të madhe rreth angazhimit në mësim atje. Thjesht kurrë nuk më pengonin kur shihnin që po mësoj, qoftë gra, burra, fëmijë e të tjerë për çka jam shumë mirënjohëse.

**Anita Susuri:** A ka qenë ajo diçka që është pranë, a ka qenë e jashtëzakonshme ni femër m'u shkollu prej asaj ane?

**Ajnishahe Azemi:** Nuk ka qenë... se ju thashë për neve si familje ka qenë ndoshta ju thashë, femrat tona nuk janë gjenerata e parë që po shkollohen. Nuk e di se e kanë prit tjerët, po baba thoshte, "Mos e mendo qysh po e presin tjerët, mendo qysh po e presim na se na po e dojmë ni femër të ngritun, ni femër që përgaditet për jetë, për komb e të tjera". Edhe nuk kom qenë gjenerata e parë, po osht' prit mjaft mirë.

Edhe fakti ishte ajo një përgjegjësi e madhe që neve na joshi për me shku në shkollë për shkak se në njëfarë mënyre ti e bartshe edhe fatin e një femrës të asaj kohe. Se nëse do të duhej të mësonim shumë, të silleshim mirë, të bëj atë që duhet të bëj që është e ndershme, e moralshme, që të përgaditë për jetë, se në një mënyrë ti sikur të bëje të tjera veprime ja u mbyllshe fatin tjerave m'u shkollu. Se, "Qe çka bojnë femrat me i çu në shkollë!" Dhe ishte kjo një përgjegjësi e jona që përpos për veti duhet me menu edhe për fatin e femrës, çka ma tutje.

**Anita Susuri:** Gjatë shkollimit të mesëm a keni marrë pjesë edhe në ndonji aktivitet kulturor? Apo a ka pasë organizime të tilla? Po mendoj edhe në shkollë po edhe jashtë shkollës?

**Ajnishahe Azemi:** Me ju thonë të drejtën nuk kom mujt me marrë shumë kohë për arsye se ju thashë që unë udhëtoja. E duhej mësimin me kry edhe me ata që kisha me udhëtu duhej të kthehesha, e të tjera. Po në një mënyrë kanë qenë do, jo formë e organizuar e angazhimeve të rinisë së asaj kohe në kuadër të cilës edhe timin, për shembull bisedonim, se si, çka duhet me lexu tash, "Cilat libra je ka i lexon ti? Hajde t'i ndërrojmë, hajde ta ndihmojmë njëri-tjetrin me libra". Nëse t'i s'kishe kujt me ja dhanë, për shembull librat e tua për shkak se gjendja ekonomike jo e të gjithëve ishte e mirë, rreth asaj se si me ja dhanë në mënyrë që me vazhdu mësimin me mësu ata, e kështu me radhë. Jo diçka të veçantë nuk kemi pasë.

**Anita Susuri:** Si kanë qenë raportet në atë kohë për shembull me... e dimë që kanë jetu edhe sërëbët në atë kohë... a ka pasë ndonji?

**Ajnishahe Azemi:** Aty në Deçan nuk kemi pasë, nuk kemi pasë në atë shkollë, nuk kemi pasë.

**Anita Susuri:** Domethonë, ka qenë shkollë shqipe komplet.

**Ajnishahe Azemi:** Po, shkollë shqipe ka qenë.

**Anita Susuri:** Mirë. Deshta pak ma shumë me u ndal tek familja juj...

**Ajnishahe Azemi:** Po, patjetër.

**Anita Susuri:** Se më tregut për jetën që ka qenë, domethonë shumica e familjeve në rrafshin e Dukagjinit kanë jetu nëpër bashkësia edhe ka ekzistuar hi hierarki.

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Si ka qenë jeta në familje, për shembull ai organizimi edhe shpija e juj, ai oborri, si po ju kujtohet juve gjithë kjo?

**Ajnishahe Azemi:** Mu po më kujtohet shumë mirë. Ka qenë hi kullë ajo, e atëhershme që deri në një kohë të caktuar na i përmbushi nevojat tona si familje për komoditetin tonë, nevojat tona. Por në kohën, në momente të caktuara me mirëkuptimin e të gjithëve, siç ju thashë kaluam në një shtëpi tjetër. Po ju thashë edhe ma përpara aty ka dominuar hi rregull, hi rend. Jo imponim por hi ndarje e detyrave dhe përgjegjësi të cilët çdo njëri i kryjke me përgjegjësi, po edhe tu e përkrah njëri-tjetrin.

Për shembull zonja e shtëpisë i kish ato obligimet e veta, zonja tjera kishin për detyrë ndoshta tri ditë diçka tjetër, për shembull, dikush e përgaditë ushqimin tri ditë, tjetra të pastroj shtëpinë e ato tjerat. Tjerat për shembull të angazhohen në punën e fushës e kështu me radhë dhe ndoshta ajo formë e organizimit ka qenë si njëfarë lloj mekanizmi (buzëqesh), një lloj organizimi i një shtetit të vogël, a din, aty familjar, që ka qenë shumë në harmoni.

**Anita Susuri:** Pastaj e keni përfunduar domethonë shkollimin e mesëm, ma tutje, domethonë i keni dhonë babës një premtim që keni me shku...

**Ajnishahe Azemi:** Po, në shkollën fillore ajo ishte, para se me fillu të mesmen.

**Anita Susuri:** Po, domethonë që keni me vazhdu edhe me fakultet, po kur ka ardhë rasti, si ka ndodhë kjo? Si keni marrë vendim?

**Ajnishahe Azemi:** Për me shku në fakultet, unë ju thashë ma parë që vëllau im ishte në Fakultetin Ekonomik i regjistruar. Edhe vet e kisha një orientim, ndoshta paraprakisht meqenëse, të studioja ekonominë. Mirëpo, e kemi pasë profesor, që është mirë me theksu këtë, nuk më kujtohet mbiemri, po Cacaj e ka pasë, i historisë, edhe hi profesor të sociologjisë që ata... ai ka qenë i fshatit Isniq nuk më kujtohet emri qetash, po kanë bërë ata që mua ma kanë ndryshu mendjen që të kthena ka shkencat shoqërore. Arsyja se ne atëherë plan-programet e gjanat si i msoshim nuk ishin ato krejt cilat e shfaqshin realitetin për shqiptarët, pozitën e tjera. Ndoshta msoshim ma shumë për historinë e Jugosllavisë e këto tjera apo në sociologji qysh trajtohet çështja kombëtare e tjera.

Edhe ata [profesorët] kanë qenë të cilët në një mënyrë apo në një tjetër, ka pasë raste kur neve na kanë thonë për shembull, "Muj me bisedu me juve diçka?" "Po, urdhno profesor. Çka osht' në pyetje?" "Këto



gjëra që i kemi në libër nuk janë si duhen, nuk janë ato që janë tonat. Nuk janë mirë për neve që t'i mësojmë si komb. Po nëse ju më premtoni që në ditar ta shënojmë kështu qysh osht' në letër në plane dhe unë t'ju shpjegoj historinë e popullit shqiptarë, atëherë ju duheni me më rujt se nuk më lojnë me vazhdu". Edhe na ja u kemi dhonë fjalën, për shembull profesorit sociologjisë qysh ta spjegoj çështjen kombëtare e tjera. Dhe faktikisht kombit, se atje ishte forma planit si ishte e planifikume atje, dhe na ja kemi dhonë faktikisht, po mendoj premtimin se ne nuk do të informojmë asgjë.

Ne në fakt edhe si individë e kuptuam që atij mund t'i ndërpritet puna, neve shkollimi e tjerë. Dhe na e kemi mësu shumë mirë historinë aty kombëtare prej tij dhe çështjen e kombit prej sociologjisë tij edhe që më ka bo m'u kthy ka shkenca shoqërore. Dhe prej atij orientimit, se që thashë domethonë osht' në Fakultetin Ekonomik, ishte qëllimi që edhe kisha pak dëshirë po edhe qëllimi që librat e tij, gjanat e tij m'i shfrytëzu. Meqenëse, tash po mendoj në çështjen financiare ma lehtë me kalu. Por, meqenëse u orientova në atë drejtim, në vitin '73 - '74 u hap dega e parë e filozofisë dhe e sociologjisë që në njëfarë mënyre (buzëqesh) m'i përmbushi ato çka unë kërkoja dhe erdha u regjistrova në Degën e Filozofisë, sociologji. Ishim gjenerata e parë, na si gjeneratë...

Pak ma herët pytët për rrethanat e kohës. Ka qenë ni periudhë e diferencimeve politike, ni periudhë jo e lehtë për me studiu edhe tjera. Mirëpo, na si gjeneratë kemi pasë ni fat të madh shumë, se shef të katedrës e kemi pasë të madhin profesor Fehmi Aganin. I cili si vajzat e tij, si djemtë e tij është kujdes për neve. Të cilin kurrë nuk ke mujt i pari me përshëndet pa të përshëndet. Ka ardhë koha e provimeve e tjera, e ka ditë si i jepshe provimet, a i dhe, a s'i dhe? Ka qenë ai që ka ditë me të këqyrë, se ju thashë që kanë qenë diferencimet politike, "Këtu duhesh m'u rujt! Këtu duhesh... kjo, kjo". Ai thjesht, nëse o njeri gjeni edhe përkushtimi për të mirën e kombit, ai ka qenë. Se thojshim, "Profesor mos u lodh bre gjitha këto gjana" "Jo se o' përgjegjësi e jemi se jemi ka, jemi ka përgadisim gjeneratat e reja për shtetin tonë, andaj duhet t'i përgadisim drejtë e t'i shkollojmë. T'i nxisim që ata të avancohen ma tepër në mënyrë që... se të tillë i duhen shtetit tonë".

Sa i përket jetës kulturore dhe këto tjerat ka qenë jo ndoshta aq e begatshme të themi kështu si organizime studentore, se ishte ajo koha që ma tepër ne e vizitonim teatrin, e vizitonim kinon. Ishte në atë kohë qysh me thonë, ishte edhe korzoja, në qendër të qytetit, tash ku osht' sheshi "Skënderbej" e këto tjera. Aty, "Zahir Pajaziti" ka qenë ni formë tjetër po aty ka qenë mramja ajo që, qysh me thonë të tjerit i takon edhe për relaksim edhe në forma tjera.

**Anita Susuri:** Si ka qenë atmosfera aty?

**Ajnishahe Azemi:** Po ju thashë, aty ka qenë ni moment që t'i ke mujt m'u taku, m'i pa, me shkëmby mendime të ndryshme e tjera, e tjera, në korzo po flas. E për të tjerat nuk ka qenë e lehtë ,se faktikisht ju thashë se ishte kohë kur ishte shumë e vështirë të bësh diçka që nuk i konvenonte regjimit të atëhershëm sepse mujshe edhe me hup shkollimin e kështu me radhë. Mujshe m'i bo dëm edhe familjes e tjerëve, tjerëve. Por, megjithatë kemi qenë, po flas na si gjeneratë, kemi qenë ni gjeneratë kompakte, ni gjeneratë e mirë që thashë fati, shumëçka kemi mujt me përjetu tuj pasë parasysh se tu i studiu shkencat shoqërore edhe domosdoshmërisht mos me dashtë të nxitesh për me qenë për të punuar diçka ashtu qysh duhet drejtë, nëse veç je i edukuar në atë drejtim. E na ju thashë e kemi pasë

fatim se vetëm ai që ka dashtë vet me gabu, se ndryshe s'ke mujt me gabu se kemi pasë këshilltarin e madh profesorin Fehmi Agani.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Ju në atë kohë në Prishtinë kur keni ardhë prej Loxhës, po mendoj edhe ma herët në Prishtinë, ka qenë totalisht ndryshe domethonë, prej fshati në qytet. Edhe ka qenë në atë kohë Prishtinë tu u ndërto...

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Edhe me ndryshimin e kushtetutës '74-tën domethonë, ka qenë si një lloj lulëzimi i Prishtinës. Si e keni përjetu ju Prishtinën?

**Ajnishahe Azemi:** Po, shiqo. Hapja e universitetit për neve, ndoshta edhe para se me ardhë une këtu, ajo ka qenë diçka që po bohet ma mirë për shqiptarët. Sepse pajisja me dije, avansimi me njohje dhe dije ishte ajo që faktikisht na bënte që na të pajiseshim, të ngriteshim, të emancipoheshim në forma të ndryshme. Ndryshimet e tilla, normalisht që unë i theksova edhe ma parë ato ishin... se sigurisht ndikonin në gjendjen e caktuar. Por, megjithatë ishte një gjendje e rënduar, se duhej të kishe kujdes shumë të madh që thashë, se boheshin diferencime në forma të angazhimit politik e kështu me radhë, të tjerat të regjimit të asaj kohe për të gjithë ata që kundërshtonin apo diçka tjetër në mënyrë haptazi. Se ju thashë angazhimet e studentëve kanë qenë në forma të ndryshme, në mënyrë ilegale e të tjera po haptazi ishte pak ma vështirë.

**Anita Susuri:** Deshta m'u nalë pak ma shumë te pamja e Prishtinës edhe qajo jeta me shoqërinë, me daljet, pak ma shumë me na tregu për qato.

**Ajnishahe Azemi:** Po, aty kemi pasë na... Prishtina gjithëherë më ka pëlqy edhe më pëlqen. Me ju thonë të drejtën në fshatin Loxhë, ju thash që deri në moshën 14 vjeçare, prej moshës 14 vjeçare mo musafir isha aty. Se shkova për gjimnaz atje, pastaj studimet e tjera.

**Anita Susuri:** Po.

**Ajnishahe Azemi:** Jo, që nuk e doja, po e du edhe tash shumë atje, e kështu relaksohem kur shkoj (buzëqesh) e tjera, se jeton vëllau tash me grunë e vet, familjen e vet. Mirëpo, jeta në Prishtinë ishte normalisht ni ndryshim i madh se tash të vish prej ni fshati në një familje, në një ambient tjetër, nuk ishte po mendoj ajo që nuk ndikonte në neve. Por, gjithëherë ka ndiku edhe pozitivisht sepse thashë na kemi qenë një gjeneratë shumë kompakte e filozofisë-sociologjisë, ku edhe sot e kësaj dite takohemi me kolgët e fakultetit, i mbaj kontaktet, takohemi këtu në Prishtinë me shoqet e fakultetit. E kemi pasë edhe menzën e studentëve e aty për ushqimet e tjera të sigurime, i kemi pasë dy racione, drekën edhe darkën dhe kështu që të tjerat u dashke t'i sigurojmë vet.

**Anita Susuri:** Ju në atë kohë me siguri jeni taku edhe me bashkëshortin, a po?

**Ajnishahe Azemi:** Jo {mohon me kokë}.

**Anita Susuri:** Nuk është kjo koha?

**Ajnishahe Azemi:** Jo, ajo kohë nuk është që jom taku me bashkëshortin. Ajo kur jom taku me bashkëshortin ka qenë kur unë fillova me punu në gjimnazin “Xhevdet Doda”. Ai kishte qenë aty profesor edhe ai ka qenë në ndërkohë para se me fillu viti shkollor, ai kishte shku në Radio Televizionin e Prishtinës me punu dhe hapën konkurs dhe unë u pranova. Për mu ishte me ju thonë të drejtën një gëzim i madh, se u pranova në gjimnazin edhe atëherë edhe tash mendoj se ma të mirin të Kosovës. Edhe në ndërkohë, ai ka ardhë në ndërkohë me palë që me ndihmu për plan-programin e tjera që ishin aty, kush ka ardhë në vendin e tij të punës, aty jemi njoftu pastaj (buzëqesh)...

**Anita Susuri:** Ju keni qenë fillimisht kur ka qenë “Xhevdet Doda” te katedralja ku osht’ sot, a po?

**Ajnishahe Azemi:** Po {pohon me kokë}.

**Anita Susuri:** A mundeni me na tregu pak lidhur me qato, domethonë ka qenë ni ndërtesë e vjetër...

**Ajnishahe Azemi:** Po kemi pasë ni fat se kemi pasë dislokime të shumta, ajo ka qenë ni ndërtesë që ka shërby për burg përpara. Ni ndërtesë {tregon dyshemënë} e ndërtume me dysheme të drurit, me ato dërrasa të zeza {bën sikur lyen me furçë} të lyme atëherë ju thojshin, tash nuk e di, një lloj llaku i zi, me do stufa që lëshojshin tym, e tjera, po, e tjera. Do dritare me dyll të fortë, dritaret këto kanë pasë {përshkruan me duar} grila të katit parë e tjera, thjeshtë që... me mure të trasha {hap duart}. Mirëpo, ni gjimnaz që mendoj se na ofroi, na kujtojke edhe rezistencën e kombit. Po faktikisht ndoshta edhe na bënte m’u ndje keq se si ndoshta ata njerëz janë maltretu, kur shkoje në podrum apo diku tjetër. Çka ka ndodhë me ata njerëz që kanë qenë këtu?!

Në gjimnazin “Xhevdet Doda” siç ju thashë une jam prej vitit 1980, 1 shtator deri më 1. 8. të këtij viti, plot dyzet vite. Në vitin ‘73 [‘83], na kemi vazhdu këtu, në këtë ndërtesë në vitin ‘73 - ‘74 [‘83 - ‘84], na kanë dërgu në ndërtesën e re, atëherë të shkollës së mjekësisë ku kemi punu deri në vitin ‘87. Dhe është karakteristike për periudhën paraprake të përmendët këtu se edhe në periudhën e gjatë luftës se të gjithë nxanësit tonë kanë qenë... qysh kur ka fillu greva e minatorëve kanë pasë ni solidarizim me minatorët dhe të rrinë radhazi aty, me orë të caktuara në podrum kemi qëndruar. Po ashtu është karakteristik se në vitin ‘90 - ‘91, i kemi lëshu dëftesat pa, pa vula. Ajo që e bonte pse, vetëm me nënshkrimin e drejtorit dhe të kujdestarëve të klasëve, për arsye se atëherë kishte fillu represioni i Sërbisë, faktikisht ndaj arsimit shqip dhe ëkrkonin që na të punonim me plan-programet e Sërbisë.

E ne në asnjë mënyrë nuk prananim ato, as nxanësit, as prindërit e tyre dhe menjherë ata fillun të vendosin drejtorinë e dhunshme. Ku drejtoresha e atëhershme që e kishim Selvete Limani, u shkarku nga detyra me 1. 11. 1991 dhe na prunë ni drejtoresh të dhunshme Radovanka Oroshin, që ka qenë një që thjesht nuk e dike punën e vet po ka qenë shumë e ngarkuar politikisht. Edhe u mundu thjesht me

bo ma të keqen për neve. Mirëpo, ne megjithatë vazhdonim punën tonë dhe ajo që ishte ma e keqja për neve pastaj në fillim atje, meqenëse nuk i pranonin plan-programet e Kosovës, kërkoj falje plan-programet...

**Anita Susuri:** E Sërbisë.

**Ajnishahe Azemi:** E Sërbisë. Dhe vazhdum me punu me plan-programet që atëherë institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, Enti Pedagogjik dhe institucionet e tjera përgjegjëse i hartun plan-programet të bazuara në kushtetutën e Kaçanikut dhe pastaj erdh... na ndoqën nga shkollat, nga ndërtesat. Filluam, filluam pastaj një kohë pa angazhim, por që tuboheshim në forma të ndryshme nxënësit me prindërit e tyre para shkollës me kërkesë për lirim e objekteve tona shkollore, por ata nuk na e mundësun. Po na si shkollë, më kujtohet shtatori, u takum edhe vendosëm me dalë, me protestu ashtu siç e kishim vendos kohën në mëngjesin e hershëm me dalë edhe shkum.

Aty ka qenë ni guxim (buzëqesh) i disa nxanësve të shumtë, dhe u bë një kohë që u bënë 17 nxanësa, erdh ni periudhë që nuk kishte të tjerë. Tu bashkëbisedu me nxanësa, bashkë me ta e pamë të arsyshme dhe vendosëm që ta hapim shkollën tonë, po ish karakteristik se si ta hapim shkollën së në të dy anët, në dy pjesët {tregon me gishta} e shkollës ishin dy tanka. Tash na vendosëm tu bisedu me ta se nëse e hapim derën e shkollës, hymjen ku ishte kryesore, ata meniherë na shohin, na ndërprejnë edhe nuk bojmë kurgjo edhe pastaj dhuna, represioni ndaj nesh.

Edhe ju thash, “Po, a dini çka? Na kemi leje ta hapim shkollën dika tjetër”, se e njihsha mirë, se punojsha prej kohësh. Thashë, “Meqenëse kjo është ndërtesë e vjetër edhe i ka do grila, po ato grila janë të mundshme, që ndoshta ju mundeni edhe diçka bashkë mundemi me i hjekë ato grila edhe me hy ka” dritarja ka qenë e podrumit, të banjove {përshkruan me dorë} të podrumit. Edhe kemi shku atje bashkë me ata 17 nxënës edhe vendosëm me hap. Se na merrte menja, bile së paku nëse s’mujm me qëndru aty, s’na lënë ta hapim shkollën, të hymë në shkollën tonë.

Thjesht me shpreh revoltën, se na jemi identifiku faktikisht me kërkesat tona se duam arsim shqip, nuk duam një arsimim tjetër. Dhe aty një prej nxanësve shkoi edhe i murr do gjana, te aty... do kanë qenë nër gjimnazin “Xhevdet Doda”, aty do dyqane e tjera, erdh aty dhe e hapën ate. Jo, para se me vendos me hap, thashë, “Mirë, po e hapim, po e kam një kusht” “Cili osht” tha, “profesoreshë?” Thashë, “Ju jeni të ri, me bo me ju zonë ata juve ja u shkaterrojnë jetën. Unë kom jetu sa kom jetu edhe nëse më zanë, ju do t’ju thoni atyne nëse vijnë me na zanë se, ‘Profesoresha na ka shti’”.

Gjithë, dashti ati që gjithë atyre ju jepsha mësim edhe mu bind ata, ju thashë, “Nëse ju thonë pse e hapët shkollën? Pse ndihmut me hap shkollën?” “Na kërcënoi se nëse nuk ndihmoni me hap shkollën, unë do t’ju hupi vitin edhe na u frigum” e tjera. Dhe ata hapën derën dhe ju thashë, “Unë do të hy e para, do të hy, po ju nuk do të hyni për arsye se ju zonë”. Kur hymë ka qenë bukur poshtë {tregon me duar lartësinë} me kcy prej një dritares se podrum, ma nalt atje.

**Anita Susuri:** Po.

**Ajnishahe Azemi:** Po, atëherë isha edhe ma e re edhe nashta vullneti për të bërë diçka, po falë edhe atyre nxanësve... po du me çelë derën e banjove mrena që ishte e mbyllun. Ju thom, “Nuk... osht’ e mbyllun. Unë këto s’ muj me hap” {ngrit supet}. Pa prit, pa kujtu veç kur u gjujt ni nxanës, tash osht’ advokat, Mentor Bogaj. “Profesoreshë une e hapi tash”. Ata fillun me hi krejt, “Jo, jo leni, mos hyni krejt, se po ju zonë!” Edhe ai shkelm edhe e hapi derën. I kom thonë, “Mentor, ruju ti ik dika se mos po të zonë”. Kom hy e kom hap derën prej anëve tjera në ndërkohë, kanë fillu me ardhë kolegët, drejtoresha e të tjerët, gjithë po më kqyrin me habi {ngrit supet sikur habitet}, une prej mrena pe hapi derën. Po ka qenë ni karakteristikë se as nuk erdhën, as nuk na pengun, as...

**Anita Susuri:** Kolegët serbë?

**Ajnishahe Azemi:** Jo, kolegët serbë, po thashë që kanë qenë dy tanka, në anën {tregon me duar në dy anët e kundërta} jo ka...

**Anita Susuri:** Tanket, aha ushtarët.

**Ajnishahe Azemi:** Jo ka banjot atje ka dritarja, po tankat e ushtrisë serbe.

**Anita Susuri:** Aha.

**Ajnishahe Azemi:** E as nuk na pengun, e as nuk erdhën e tjerë, me na pengu për në hapjen e saj. Edhe na mbetëm në atë shkollë. Normalisht pastaj në shkollë kanë ardh, “Qysh e hapët?” e tjerë, po jo me na hjekë. Ndoshta ajo ka qenë, qysh me thonë, ni manovër politike që ata para botës ndërkombëtare me thonë që, “Na po i lojmë, po këta s’po dojnë. Qe e kemi ni rast që po punojnë në objektin shkollor se na po i lojmë, nuk po i pengojmë”. Edhe mendoj që ajo ka qenë, a di kështu, dhe dashti fati që faktikisht të vazhdojmë me punu në atë, në atë lokal deri në ‘87-tën, pastaj prapë u kthy, na kanë dërgu për shkak të nevojave të kohës, të lokalit, që vinte atëherë për çështje të ndryshme, të tjera arsimore edhe shkollat tjera. Neve na dërgun në shkollën e mjekësisë.

**Anita Susuri:** ‘97-tën, a?

**Ajnishahe Azemi:** Jo, ‘87-tën u kthym këtu. Punum faktikisht deri në vitin ‘83, ‘93 sa ishte 2003-2004.

**Anita Susuri:** Po.

**Ajnishahe Azemi:** Pastaj meqenëse u vendos lokacioni i gjimnazit “Xhevdet Doda” të jipet për katedralen, na u desht ta lëshojmë, se nuk e dishim kur ata po vendosin dhe aty e shfrytëzojshim për nevojat e periudhës caktume. Dhe na punum deri 2010-tën në ndërtesën e vjetër të gjimnazit, të shkollës së mjekësisë ku me 2010-tën u ndërto, u ndërto kjo shkolla, ndërtesa e re tash ku jemi në Lakrishte. Dhe gjimnazi “Xhevdet Doda” ka qenë dhe është gjimnaz i fortë, një gjimnaz që ka kontribu shumë në përgaditjen, në shtetndërtimin e Kosovës. Duke përgaditë dhe edukuar, dhe arsimuar shumë gjenerata të brezit të republikës. Të cilët faktikisht kanë kontribu edhe për shtetin e tjera. Ka pasë dhe ka një kolektiv të zotin, të përkushtuar.

**Anita Susuri:** Deshta m'u ndërlidhë edhe pak ma herët me demonstratat e vitit '81.

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Ku keni qenë ju atë ditë, për shembull edhe sigurisht disa nxanës të juj kanë marrë pjesë?

**Ajnishahe Azemi:** Ajo ka qenë... në shkollë kam qenë, në shkollë t'u punu. Unë studente atëherë veç s'isha mo, veç sa kisha filluar me punu dhe ka qenë një kolege e imja që bashkë, e re edhe ajo, që kish fillu me punue edhe na p'e shohum që po ndodh diçka atje. Edhe i them asaj, thashë, "Çka po bojmë? Po ndodh diçka te studentat atje, osht' ka ndodh, çka të bojmë? A të shkojmë?" "Të shkojmë". Po na thjesht, nuk isha e kyçun, nuk isha e kyçun në organizimin e tyre apo diçka tjetër, po të shkojmë a po mujmë a, diçka me bo.

Para se me shku te Fakulteti Filozofik bashkë me atë shoqen dhe nga dukja dukeshim shumë të reja, ata si duket mendonin që ishim studente, na dyja profesoresha ishim aty po shumë të reja, po mendoj edhe për nga pamja. Edhe na kthyn nuk na lan me shku se në njëfarë mënyrë na mendum me ju bashkangjitë asaj turme, se protestat e studentëve a din, pak kishim njohuri për ato lëvizje që po ndodhin atje. Dhe ishte një kërkesë se nuk ishte ajo e para që, "Duam kushte për studentë" se e disha qysh jonë kushtet në menzë. Se gjatë studimeve veç e kisha frekuentu atë vend shumë mirë.

**Anita Susuri:** Po.

**Ajnishahe Azemi:** Dhe ndoshta nuk ishin ato drastike sa ndoshta me bo diçka, po ni shkas, po thjesht nuk na lan. Ka qenë domethonë ajo që në shkollë kam qenë.

**Anita Susuri:** A ju ka ndalu policia apo?

**Ajnishahe Azemi:** Policia na ndaloi edhe nuk na la me shku, nuk na maltretoj po nuk na la me shku.

**Anita Susuri:** A ka pasë nxanës të juj që kanë marrë pjesë?

**Ajnishahe Azemi:** Po, sigurisht ka pasë, po jo që unë ndoshta posaçërisht kam qenë në atë kohë atje.

**Anita Susuri:** Pastaj prej vitit '81 veç ka fillu domethonë me u prish situata, me u bo edhe ma e keqe.

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Si e keni vërejtë ju? Në çfarë momenti e keni vërejtë, për shembull që po bohet ma keq? A e keni vërejtë...

**Ajnishahe Azemi:** Po, ju thashë atje, fillun në gjendje sociale, ekonomike, politika e asaj kohe ishte shumë e rënduar dhe ato e shihshe vet që ka ndodh ajo. Edhe në raste të caktume pastaj fillun ato angazhimet e kohës, po mendoj lëvizjet e kohës që ju thash, qysh prej atje me grevën e minatorëve, nxanësit tonë u solidarizun dhe ne mësimdhënësit tjerë bashkë me ata në podrumin e shkollës atje. Pastaj nxanësit tanë më kujtohet kur ishin në demonstrata, faktikisht protesta gjithëpopullore.

‘89 kur është suprimu autonomia e Kosovës, atëherë na ishim në shkollë te ndërtesa e vjetër dhe çfarë bënë, fillun prej jashtë të gjujnë me gurë apo diçka tjetër, kush ishin ata nuk e di. Na kërkum prej nxanësve meqenëse tash për momentin... të dalin nalt kështu që mos të lëndohen, por atje nalt edhe ishte rrezik me ndejt se ndërtesë e vjetër m’u rëndu shumë edhe ato sa ishin të forta. Po nga ana tjetër se ishte vullneti edhe i nxanësve edhe i neve me dalë me ju bashkangjitë protestës, dhe dolëm gjithashtu ju bashkangjitëm protestës dhe pastaj edhe në protestat e tjera.

**Anita Susuri:** Çka keni pa në qat’ protestë ju?

**Ajnishahe Azemi:** Përpjekjen e popullit.

**Anita Susuri:** A keni pa që po e rrah, dikush dikon po e rrah apo?

**Ajnishahe Azemi:** Po, po.

**Anita Susuri:** Mundeni me dhonë ni përshkrim.

**Ajnishahe Azemi:** Ka qenë Ali Zatriqi apo dikush tjetër, e ka pasë këtu {prek kokën dhe ballin} e kanë rrah këtu, i dilte gjak, nëse s’gabo. Prindi ka qenë doktor, praktikisht doktor Skender Zatriqit, i cili bashkë me bashkëshorten e tij ma vonë na ka ndihmu shumë në një pjesë tjetër, këtyne aktiviteteve e Forumit. Po edhe rrahjet e ndryshme të formave të ndryshme të maltretimit të asaj kohe, e tjera atje kanë qenë. Diçka që e shihshe popullin tond se po vun, po ni popull që krenoheshim me atë se e dijmë çka kërkojmë, çka dojmë për me mujt me mrrri drejt realizimit të qëllimit, jo vetëm për kushte më të mira po realizimi i synimeve që Kosova të jetë atje faktikisht republikë e pavarur në atë kohë edhe brenda qoftë Jugosllavisë, po në një njësi faktikisht tjetër, e kështu me radhë.

**Anita Susuri:** Ju domethonë në vitin ‘89 jeni bashkangjitë Lidhjes Demokratike, faktikisht kur është organizu nji, është bo Lidhja Demokratike, krahas kësaj është bo edhe Forumi i Gruas.

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Si ka ndodh kjo, domethonë a ka qenë ideali që ju ka shti me hy në politikë apo çka ka qenë ajo që ka ndiku?

**Ajnishahe Azemi:** Fillimisht unë kam qenë... jom kyç në Lidhjen Demokratike të Kosovës në vitin ‘89, që prej themelimit dhe në Forumin e Gruas, që prej themelimit 1990. Dhe kam vazhduar aktivitetet dhe angazhimet e mia ku jom edhe sot. Ajo që më shtyni, ndoshta pa e elaboru ma shumë këtu, nëse më

lejoni të them disa fjalë për prijësin tonë president, presidentin historik të Republikës së Kosovës, doktor Ibrahim Rugovën.

**Anita Susuri:** Po?

**Ajnishahe Azemi:** Ai ishte një njeri me vlera të shumta, një letrar i madh, një njeri i mençur, një njeri i urtë, një njeri që dinte të dëgjonte dhe respektonte mendimin e tjetrit. Një njeri që bënte thirrje për durim, një njeri që bënte thirrje për pajtim. Një njeri që e udhëhoqi popullin e Republikës së Kosovës në rezistencën e tij drejt lirisë dhe pavarësisë. Kishte një vizion të përbashkët, të plotë, në përputhshmëri të plotë me kërkesat dhe interesat e popullit për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

E udhëhoqi Lidhjen Demokratike të Kosovës si forcën politike më të madhe në vend prej themelimit deri në rastin e vdekjes. Mënyra e promovimit të tij që e bonte, faktikisht urtësia, mençuria, promovimi i tolerancës, mirëkuptimit, pajtimit që e promovonte në botën ndërkombëtare, faktikisht demokratike. Dhe vizioni i tij për liri dhe pavarësi e demokraci të Kosovës ishte në përputhshmëri me popullin. Arriti ta bind botën ndërkombëtare që të na përkrahin, faktikisht në mënyrë që vizioni i presidentit dhe i popullit të Republikës së Kosovës të bëhet realitet.

Normalisht përkrahur edhe nga forcat e tjera, Ushtria Çlirimtare e Kosovës që e bëri një luftë heroike të udhëhequr nga komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari. I cili nuk kurseu asgjë nga vetvetja as jetën, as edhe faktikisht familjen ma të shtrejtën. Dhe kontributdhënësve të tjerë, të cilët edhe sot janë gjallë, Kosova arriti të jetë e lirë, të jetë e pavarur.

**Anita Susuri:** Kur e keni taku ju për herë të parë Rugovën? Edhe çfarë mendimi keni pasë fillimisht për të?

**Ajnishahe Azemi:** E kom taku menjherë '90-tën, kështu drejtpërdrejt. Për arsye se ajo ka qenë një kohë kur na, Forumi Gruas organizohej, patëm fillu të organizoheshim, në fillim, se Forumi i Gruas ka qenë si shoqatë pastaj si forum në formë të veçantë. Po ka qenë ajo që në mënyrë të drejtpërdrejt një shoqatë, ka qenë njeri i shoqatës së shkrimtarëve kur atëherë praktikisht Lidhja Demokratike i ka pasë zyret e veta dhe aty kemi pasë organizime të tjera dhe kemi vazhdu. Ka qenë një njeri i lehtë me u taku, se të ka pranuar siç e thashë, e ka respektu mendimin e tjetrit. Ka pasë një tolerancë, ka pasë një respekt në mendimin e tjetrit edhe e ka respektu mendimin e tjetrit. Jo vetëm që e ka ndëgju po edhe e ka respektu.

Pra, në fakt doktor Ibrahim Rugova e udhëhoqi një lëvizje gjithëpopullore të lirisë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës, se jo vetëm ata që faktikisht ishin të kyçur në Lidhjen Demokratike të Kosovës që të vijnë faktikisht këtu ku jemi, po edhe i gjithë populli. Sepse vizioni i presidentit Rugova dhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës ishte në përputhshmëri me vizionin e popullit, prandaj edhe e gëzonin atë përkrahje. Se e ka pasë përkrahjen e popullit dhe ishte përputhshmëri e plotë me vizionin e popullit, vizioni i doktor Rugovës dhe i LDK-së. Faktikisht na tregonte dhe fakti varrimi i presidentit Rugova, kur në njëfarë mënyre mund ta quajmë lirisht një referendum, një dëshmi se ka qenë dhe osht' i përkrahur si



vizioni i tij për Kosovën, që të jetë e lirë, aty ku ishte, që të jetë e pavarur po që të bëhet e pavarur edhe të jetë, të bëhet demokratike.

Edhe pse ai gjithmonë ka pasë... kërkesat e tij që Kosovën ta shoh si një Kosovë të lirë, të pavarur dhe demokratike, një Kosovë të kyçur në Bashkimin Evropian, një Kosovë në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjithë botën demokratike. Prandaj e keni pa sa burrështetas, sa popull, edhe çfarë kushte kanë qenë atëherë, varrimi i tij sa njerëzit kanë marrë... Kjo është një shprehje e gjithë atyre që bënë nderim për njerin e madh që kontriboi shumë për Kosovë dhe për kombin shqiptar.

## Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** Deshta me thonë, nëse mundeni me fol se si u formua Forumi Gruas edhe pse nuk mbetet në LDK, po pse pat nevoj që m'u bo ni forum i grus?

**Ajnishahe Azemi:** Ishim në... ndoshta këtu do të them shkurt që në ndërkohë gjatë prezentimit tim faktikisht të asaj se çfarë ishte atje me t'u përgjigj në pytjen tuje. Ishin nevojat e kohës faktikisht që edhe gruaja të jetë e angazhuar edhe pse në Lidhjen Demokratike të Kosovës pat femra, po ishte një mundësi që, që edhe gruaja e Kosovës faktikisht gruaja qoftë në Lidhjen Demokratike të Kosovës... thashë Kosovës sepse ajo në njëfarë mënyre ishte edhe lëvizje gjithëpopullore dhe një mundësi që gratë e Kosovës të japin kontributin e vet edhe ma shumë të jenë të përfshira sepse më shumë se gjysma e popullatës jemi. Në mënyrë që edhe ato të jenë të kyçura në mënyrë të drejtpërdrejt në realizimin e vizionit për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Nëse më lejoni uën do të kisha cekë këtu disa nga pozitat e mia, përgjegjësitë, detyrat, që unë i pata ndër vite në Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe në Forumin e Grusë të Lidhjes Demokratike të Kosovës të cilat ndërlidhen me të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Forumit të Grusë. Fillimisht isha anëtare e kuvendeve edhe të Forumit të Gruas edhe të nëndegës së Forumit të Gruas, e të nëndegës së LDK-së në Kodrën e Trimave, që është dega e parë. Dhe menjëherë, aty automatikisht isha edhe delegate e kuvendit të parë të Forumit të Grusë, të degës së parë dhe aty na faktikisht bëmë organizimin e kuvendit, e tjera.

Pastaj, pas... në zgjedhjet e tjera prapë vazhdova. Faktikisht në atë kohë isha edhe kryetare e nëndegës së parë të Forumit të Grusë, me qëllim të organizimit të femrës së asaj pjesë. Por, në zgjedhjet e dyta të LDK-së prapë isha delegate e kuvendit të nëndegës të LDK-së dhe të nëndegës së tretë dhe të degës së parë të LDK-së, dhe në mënyrë që ashtu faktikisht të mund të jap kontributin e kohës në atë, në atë kohë faktikisht. Pastaj vazhdoj në kuvendin e tretë të Forumit të Gruas, të degës së parë faktikisht t'u vazhdu me ato mekanizmat, që mos t'ju marrë kohë, që thashë shkon kuvendi i nëndegës, dega, nëndega, dega, e kështu me radhë. Në vitin 2005 u zgjodha kryetare e Forumit të Gruas të degës së parë të LDK-së, të cilën e udhëhoqa deri në vitin 2016.

Pastaj isha në të gjitha zgjedhjet të LDK-së prej kuvendit të tretë që është mbajtur në restorantin “Dora” [tregon me gisht djathtas] atje, ‘97-tën. Isha delegate jo vetëm e kuvendit të nëndegës, degës, por edhe të kuvendit qendror të LDK-së, që mora pjesë në atë kuvend. Pastaj vazhdova edhe njëkohësisht ishin edhe ato angazhime paralele të Forumit të Grusë edhe të LDK-së, qoftë në nivel të degës apo në nivel qendror. Vazhdova që të jem gjithëherë në të gjitha, që të mos ndalem kështu ndoshta për çdo kuvend, të jem delegate e të gjitha kuvendeve të nëndegës edhe të degës së LDK-së edhe në Kodrën e Trimave dhe të Forumit të Grusë, po të jem edhe delegate e të gjitha kuvendeve edhe të nivelit qendror të LDK-së në degën e kuvendit të fundit.

**Anita Susuri:** Deshta, deshta pak me detaje me u nal te...

**Ajnishahe Azemi:** Po, patjetër.

**Anita Susuri:** Vitet e ‘90-ta, sepse janë përplot me ngjarje. Osht’, domethonë krahas aktivizmit politik është edhe puna në shtëpi-shkolla tashmë. Nëse mundeni me fol fillimisht pak ma shumë për këto, domethonë për shtëpi-shkollat edhe për angazhimin e juv domethonë si profesoreshë. Pastaj flasim edhe për, për domethonë organizimet që i ka bo Forumi i Gruas.

**Ajnishahe Azemi:** Angazhimet te Forumi i Gruas kanë qenë të lidhura edhe me Lidhjen Demokratike të Kosovës, po kanë qenë edhe disa specifika të cilat meqenëse that ju i elaborojmë pak ma vonë. Ishte ajo që në shtëpitë-shkolla, ishte ajo që me ndërprerjen e mësimin në shkollat shqipe Forumi i Grusë i inicoi dhe e filloi aksionin dy orë mësim në shtëpi. Në mënyrë që ata fëmijë tanë, të rijtë tanë që ishin nëpër shtëpitë e tyre, jo ndoshta që kemi mujt na me shku me ja u çu msuset atje, por të bohet një organizim dhe një diçka që ata ta dijnë që dikush o ka mendon për ta edhe pse nëpër shtëpi, e tjera.

Por osht’ ajo që unë po e ndërliidhi se këtu ndoshta me... osht’ fshtirë me të vërtetë me elaboru të gjitha këto gjana se ndërliidhen në shumë aspekte dhe nga gjimnazi edhe nga aktiviteti e tjera, e tjera. Po mundona disa prej tyre t’i flas me juve. Thashë edhe ma herët se në shtëpitë shkolla na veç shkuam tek faktikisht në janar. Meqenëse, ju thashë, neve na largun prej shkollave, mbetëm nëpër shtëpia, pastaj institucionet tona duke u bazuar faktikisht në kushtetutën e Kaçanikut, faktikisht i hartun plan-programet e tjera.

Dhe si rezultat i mospranimit të planeve tjera dolëm në shpia, po ato organe patën vendosë që me 20 janar, ‘92, të fillojë mësimi në shtëpitë shkolla. Na si shkollë patëm fillu ma përpara pak, po në janar, thashë. Dhe osht’ ajo karakteristikë se kemi pasë... mu më vjen keq se nëse filloj me emra, disa prej atyre pronarëve që na kanë lëshu shtëpitë-shkolla, më kujtohen emrat po jo të gjithëve, prandaj me respekt ndaj çdonjërit prej tyre nuk po filloj me përmend emra, se kontribut i të gjithëve ka qenë. Por po filloj pjesërisht ku kanë qenë ato.

**Anita Susuri:** Ku kanë qenë, po.

**Ajnishahe Azemi:** Na kemi pasë, kemi pasë dhomë në katin e tretë, faktikisht përdhesë, kati i parë, i dytë, në Aktash. Ku aty kam pasë fatin që ta kem edhe klasën time, ku isha kujdestar. Respekt mbi të

gjithë ata për ata se në çfarë mënyre na kanë trajtu, qysh na kanë trajtu, qysh e kanë mbajtur atë dhomë pastër, qysh e kemi pasë njetë, edhe nuk kanë pasë... E kemi pasë improvizu {shikon përreth} tavolina kanë marrë nëpër kojshi a s'di ku i kanë marrë, se s'besoj që i kanë pasë gjithë ato tavolina. Edhe të dhomës e tjera, kështu i kanë renditë {shpjegon me duar} në formë të kandit dhe karrikat përreth asaj edhe ni stufë, sikur sot më kujtohet, po pastër, pastër, mirë. Kemi pasë po ashtu këtu në Aktash, te këto banesat e vjetra ku nalet autobusi aty në Kodrën e Diellit, aty para se m'u nisë ato banesat e reja që osht' stacioni i autobusave.

**Anita Susuri:** Po, po.

**Ajnishahe Azemi:** Aty e kemi pasë ni klasë. E kemi pasë ni klasë tjetër, tamam kur don me përfundu Kodra e Diellit {përshkruan me duar}, ka qenë më kujtohet shumë mirë, në anën {tregon djathtas} një shtëpi e vogël. Po ata njerëz aq bujar, që e kishin lëshu atë dhomë, çfarë kushte, se ishin ngushtu shumë për veti. Në anën e djathtë ka qenë. E kemi pasë ni dhomë mësimi edhe në lagjen Emshir, tre. E kemi pasë ni dhomë tjetër në lagjen Vneshta. Këtu nëse më lejoni kisha theksu diçka, faktikisht është ajo që gjithë këta pronar, për ta ish ni sakrificë e madhe, t'i hapin dyrtë për angazhime të tilla që ata e dinin që po e sakrifikonë veten dhe familjen.

Po ata ishin njerëz të përkushtueshëm për të kontribuar në arsimin dhe edukimin e gjeneratave, mos me i lonë keq, arsimimin e nxanësve tonë dhe për çdo student tonë nëpër shpia. Kemi pasë edhe një tjetër mos të harroj, më vjen keq nëse e harroj, një tjetër që ajo na shërbente ndoshta në atë kohë na shërbeu edhe si një lloj drejtorie. Në fund të atij viti shkollor, na aty edhe provimet edhe krejt tjerat se nuk zhvillonim mësim thjesht formal, vetëm po mësojmë, po vërtetë u mendojmë me bo mësimin mrenda mundësive ashtu si duhet. Po dikun ishin kushtet ma të mira, dikush, dikun ma të fshtira, po megjithatë ata na mundësun që ta majmë mësimin në shqip.

Dhe faktikisht më lejoni të them diçka, jo pse kam qenë dhe jam aktiviste e Lëvizjes Demokratike të Kosovës, në atë kohë ishte përhapë mendimi se presidenti Rugova po bon thirrje për pajtim, për durim, për moslëshimin e Kosovës, për ruajtjen e pragut të shtëpisë, e tjera, e tjera, që theksova më parë. E që fëmijët e vet i ka çu diku jashtë e po i run, që ajo nuk ka qenë e vërtetë, se djali i tij Mendimi, ka qenë pikërisht, ka mbajtur mësim në lagjen Aktash se atij i ka ra aty, klasa e tij ka dasht fati me qenë atje. E domethonë, e ka majt, e me thon, "Jo kjo, jo", "Jo bre, munesh me ardhë me pa. Mundesh me pa Mendimin që o i ulun ku osht'. Qitu osht'". Dhe ka qenë ndoshta çdo orë edhe në ato protesta para shkolle, e tjera, e tjera aty.

**Anita Susuri:** A ka qenë rrezik për juve në ato kushte?

**Ajnishahe Azemi:** Rreziku ka qenë i madh dhe ka qenë fshtirë për ne, se meqenëse u ndërpre edhe financimi. Tash unë ju thashë, për shembull se edhe kolegët e mi, gjithë profesorët tjerë tash dikush ka dashtë fati me pasë ma ngat naj klasë, dikun tjetër, po nuk e kemi pasë... njëmend të gjithë e kemi pasë fshtirë se nëse e ke pasë naj klasë ma afër tjetrën e kanë pasë pak ma larg, thjesht se nuk ishin në një vend. Une thashë se banoj në Kodrën e Trimave, thashë afër parkut të Arbërisë, llogarite ishte një gjendje ma e rënduar se ti në atë kohë ishte edhe pa financim edhe vet edhe bashkëshorti. Se

bashkëshorti ka punuar në Radio Televizionin e Kosovës edhe e ka, faktikisht ka qenë i larguar prej të parëve edhe para okupimit të Radio Televizionit, me 5 gusht të '90-tës. Dhe na ishim pa financim, tash u ndërpre edhe financimi im edhe mbetëm pa financim.

Kjo identifikohet edhe me të tjerë, kështu kanë qenë. Edhe të shkosh prej Kodrës Trimave, që ka ndodh ditë që për shembull kam pasë mësim, organizim i orarit, të shkosh në lagjen e Vneshtave, që s'kishe pare për autobus, prej atje të shkosh në Kodrën e Diellit dhe prej Kodrës Diellit të shkosh në lagjen e Vneshtave me majt mësim edhe të kthehesh në shtëpi. Në anën tjetër në shpi ka pasë ditë që i kom dhonë në mëngjes fëmijëve bukë, po nuk kom lonë bukë në shpi, si qëndrun ata? e tjera. Llogarit në çfarë gjendje i kom lonë fëmijët, po edhe të tjerët, të gjithë ashtu kanë qenë. Shumica prej tyne kanë pasë fatin, dikush ka pasë mundësi, po financim si familje kemi pasë atëherë dhe nuk ka qenë e fshtirë. Po motivi për të dhënë kontributin për nevojat e kohës për arsimimin e gjeneratave bënte që, thjesht po ju them, më duket se nuk lodhesha, nuk lodhesha. Se ishte ajo diçka që po kontribon, po punon.

**Anita Susuri:** Në Forumin e Grusë, kanë qenë edhe disa aktivitete që janë bo, me protesta, është me çelësa, me letër të bardhë, me bukë...

**Ajnishahe Azemi:** Une meqenëse më thatë që do kthehemi, në ndërkohë i bane do pyetje, e lash këtë pjesë ta elaboroj tash e tutje. Thashë se aktiviteti i Forumit të Gruas të Lidhjes Demokratike të Kosovës, faktikisht në kuadër të cilit ka qenë edhe aktiviteti im personal dhe i gjithë bashkëveprimtarëve të tjerë edhe bashkëveprimtarëve, ka qenë pothuajse në gjithçka i përbashkët me LDK-në. Atëherë Lidhja Demokratike e Kosovës thashë ishte forca ma e madhe politike në vend e përkrahur nga Forumi i Gruas, arriti... po shkoj në mënyrë kronologjike të ngjarjeve, nëse më lejon?

**Anita Susuri:** Po, po, patjetër.

**Ajnishahe Azemi:** Arriti që faktikisht të themelojë dhe organizojë institucionet e kohës të Republikës së Kosovës. Institucionet arsimore, pastaj institucionet faktikisht shëndetësore të kohës, hartimin e plan-programeve që e tham. Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrahur normalisht nga Forumi i Grusë dhe padyshim e përkrahur nga gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, arriti t'i organizojë zgjedhjet për pavarësinë e Kosovës në vitin '90, '91 faktikisht. Dhe të vazhdoj me organizimin e zgjedhjeve të para parlamentare dhe presidenciale, në të cilat për herë të parë kryetar i shtetit u zgjedh doktor Ibrahim Rugova.

Po thjesht, meqenëse ky vizion për lirinë dhe pavarësinë i Forumit të Grusë të LDK-së për përputhshmëri faktikisht me popullin ishte ajo që na shtynte dhe kishim përkrahjen e popullit dhe na bënte që të shkojmë përpara, të organizojmë diçka që i bën mirë Kosovës, të avancimit të çështjes e kështu me radhë. Mirëpo, tham edhe që ndoshta do të isha ndalë, meqenëse kërkuat ju, që të ndalem pak ma tepër në aktivitetet e Forumit të Gruas. Thashë që Forumi i Grusë qysh në fillim ju ka bashkangjitur aktivitetit të LDK-së, po edhe disa aktiviteteve të tjera. Që më vjen keq që nuk mund t'i përmend se një jetë punë, më vjen keq nëse s'mrri t'i përmendi.

Po janë të theksuara faktikisht disa, faktikisht qysh ju thashë atje, dy orë mësim në shtëpi, faktikisht kërkesat për parandalimin e dhunës ndaj shkollës shqipe, represionit që bëhej, kërkesa për lirim e të burgosurëve politik të asaj kohe. Pastaj kërkesat e ndryshme që kishim rreth asaj, se faktikisht të ndërprehet gjenocidi, faktikisht dhuna ndaj djemëve tanë dhe në ushtri që na i kthejshin me arkivole. Ishte përpjekja jonë, benim atë që mujsim në atë kohë për promovimin e faktikisht gjendjes në Kosovë, qarqeve të ndryshme ndërkombëtare të kohës, kërkesa për parandalimin e dhunës ndaj grave e fëmijëve. Vrasjeve, si vrasja e Afrim Prebreza e tjera në atë kohë.

Për të vazhduar faktikisht po përmendi disa angazhime, meqenëse e theksove protestat kërkove, ka qenë Forumi Grusë pjesëtare e të gjitha protestave gjithëpopullore, ka qenë, ka kontribu, pjesëmarrëse e saj. Por, Forumi i Grusë i përkrahur faktikisht edhe nga gratë tjera të Kosovës, organizata tjera të grave të Kosovës, si Qendra për Mbrojtjen e Grusë dhe Fëmijës, e udhëhequr nga Sevdije Ahmeti. Pastaj, Qendra për Mbrojtjen e Nanës dhe Fëmijës që e udhëheqte [Flora Brovina](#), e kështu me radhë. Dhe të gjitha gratë e Kosovës bënë që Forumi i Grusë vet të organizoj protesta.

Jo vetëm protesta që kishin për qëllim promovimin, faktikisht avancimin e femrës apo diçka tjetër, po kërkesat që ishin të ndërlidhura faktikisht me tejkallim të gjendjes së dhunës, represionit të paparë të Serbisë në atë kohë, që ushtronte dhe bënte atë që është e mundur që proceset e tilla drejt një rruge për liri dhe pavarësi. Dhe është e njohur siç edhe thatë protesta me çelësa, është e njohur protesta me fletën e bardhë para zyrës amerikane, pastaj protesta shkurorëzimi paqësor që ka qenë në shkallët e Arbërisë, është mbajt. Pastaj, Stop Hollokaustit! e protesta të tjera që thjesht ishte organizator por e përkrahu, ngaqe...

**Anita Susuri:** A keni qenë ju aty kur është marrë vendim m'u bo në qat' formë protesta, qysh ka ardhë deri te idea? Për shembull, me çelësa ose Stop Hollokaustit?

**Ajnishahe Azemi:** Unë ju thash nevojat e kohës për me potestu edhe me ngrit zërin, me ngrit zërin dhe jo të gjitha protestat po në disa prej tyre kam qenë edhe në organizimin e tyre. Faktikisht pjesëmarrëse e të gjitha protestave kam qenë faktikisht edhe kom kontribu mjaft, po jo qysh thatë në inicimin e disa prej tyre.

**Anita Susuri:** Te cilat protesta keni qenë si organizatore?

**Ajnishahe Azemi:** Jo, unë veç vet, në asnjë mënyrë.

**Anita Susuri:** Jo, veç vet, të cilat keni marrë pjesë...

**Ajnishahe Azemi:** Te Forumi i Gruas edhe këto tjerat, po osht' Shkurorëzimi paqësor, pastaj atje që ishte, faktikisht Stop Hollokaustit e tjera që atje mund t'i shihni. Se ne në njëfarë mënyre, na ato që ishim si organizatore, që kontribonim në forma të ndryshme, se unë thashë në asnjë mënyrë nuk është vetëm kontribut i imi po i gjithë të tjerëve. Ishim në rendin e parë që mund t'i shihni dokumentacionet e ndryshme, e tjera, e tjera, qe mund edhe këtu t'ju tregoj një fotografi {tregon me dorë djathtas}.

**Anita Susuri:** Si ka qenë përballja me policinë?

**Ajnishahe Azemi:** Po përballja ka qenë, {ngrit supet dhe shikon djathtas} ajo që ka qenë.

**Anita Susuri:** Qysh po ju kujtohet juve qajo ditë?

**Ajnishahe Azemi:** Nuk e di, ato gra të gjitha, po edhe gratë tjera të gjitha ato, dukej sikur nuk trembeshin hiç. Dukej sikur ishin identifikuar me vdekje, me dhunën se, “Nuk e pranojmë atë regjim dhe ne kërkohet që kjo gjendje të tejkalohet dhe Kosova të shkojë drejt një rrugë që e bën të vendos për fatin e vet, populli i saj”. Thjesht bënte që ndoshta edhe m’u tmerru se qysh prej atij represionit po qëndrojnë ato vajza, thjesht aq të forta, aq të përkushtime për të bërë diçka. Kur ishte Bukë për Drenicën, m’u nis për në Fushë Kosovë dhe atje na dolën përpara ata [policia serbe].

Përkundrazi, ata ishin me armatim deri në dhambë, gjithë ato gra e vajza mësynin {lëviz me trup përpara} thu ti se ato s’janë armë, po janë lodra. Po qëndronin dhe ishte ajo që faktikisht, megjithatë nuk na lanë me shku edhe u desh të kthehem. Po tregon se gruaja shqiptare, faktikisht gruaja kosovare është e fortë, është e përkushtuar për lirinë dhe pavarësinë e vendit të vet. Prandaj, edhe në format që i kishte të mundshme ajo kontribonte, qoftë me protesta, qoftë me angazhime tjera.

**Anita Susuri:** Në protestën me bukë ka ndodh edhe një incident që ka pësuar një vajzë edhe disa tjera gra janë lënduar, ku keni qenë ju në ato momente, a e keni pa ato që ka ndodh?

**Ajnishahe Azemi:** Unë kam qenë ju thashë në rendin e parë, aty kanë qenë të gjitha shoqet, ka qenë Edita e këto. E në rendin e parë kam qenë, para policisë, po neve nuk...

**Anita Susuri:** Kur ka ndodh ajo si e keni...

**Ajnishahe Azemi:** Jo, nuk e kom pa.

**Anita Susuri:** ...përjetu.

**Ajnishahe Azemi:** Nuk e kom pa, ka qenë ju thashë shumë randë, po u bohshim krenar se ishim, qëndronim, represioni e këto, ti e dishe që je dalë po nuk e dishe a po të majnë a po të maltretojnë ty apo shoqen tande apo dikon tjetër edhe çdonjeri ka mujt me pësuar ashtu, po ka qenë e fshtirë dhe për atë unë nuk e kam pa.

**Anita Susuri:** Ju edhe si...

**Ajnishahe Azemi:** Dhe unë ju thashë, isha aty bash para policisë në Fushë Kosovë atje.

**Anita Susuri:** A e keni kuptuar çka ka folë, për shembull polici apo dikush, çka ju ka thon?

**Ajnishahe Azemi:** Po e kom kuptu se na shkollën, gjatë shkollimit kemi mësu gjuhën serbo-kroate se jonë kanë të detyrueshme.

**Anita Susuri:** Çka ju ka thon? Ju ka ofendu apo vetëm zbrapsuni?

**Ajnishahe Azemi:** Po tash nuk po muj m'i kujtu të gjitha ato. Domethonë, me ju thonë të drejtën 30 vjet angazhim edhe shumë gjona ngatërrohen, se ku ki thanë, apo ku ke dëgju, apo diçka tjetër, prandaj në këtë rast nuk po më kujtohet mirë.

**Anita Susuri:** Okej, në rregull. Ju edhe si grup keni vizitu shumë familje që kanë humbë anëtarë...

**Ajnishahe Azemi:** Po patjetër.

**Anita Susuri:** Domethonë, kur është afër, në vitin '98 ka qenë edhe '97, në çfarë familje keni shku edhe pse keni shku, me ju dhonë përkrahje vetëm apo edhe me ndihmu?

**Ajnishahe Azemi:** Une kisha dashtë qet' pjesë nëse më lejon ta elaboroj kur flas për angazhimin në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës?

**Anita Susuri:** Mirë, mundeni.

**Ajnishahe Azemi:** E për ato familje nëse mendon kur filloj lufta e tutje. Përpara, po si Forumi i Grusë e kemi pasë qëllim pra që e thashë që nga fillimi atje që e theksova emancipimin e femrës edhe emancipimin ekonomik edhe politik. Edhe kemi pasë qëllim edhe kemi punu në drejtim të përmirësimit të pozitës të femrës qysh nga familja, sepse ajo është celulë e emancipimit të shoqërisë faktikisht. T'u pasë parasysh se faktikisht gruaja e ka një rol të madh jo vetëm për kah numri, po si bazë e emancipimit të shoqërisë, emancipimit të familjes dhe në një mënyrë mendoj se matet emancipimi i shoqërisë me emancipimin e femrës.

Na jemi mundu që ta përkrahim, të kontribuojmë, të përkrahim në forma të ndryshme edhe social edhe ekonomik edhe arsimor. Duke përkrahur, duke u munduar që të angazhojmë edhe shkollimin e femrës, aty ku bëhej ndalimi i femrave nga shkolla. Përkrahja sociale dhe ekonomike, se vizitonim edhe ato familje, thjesht për m'i pa nevojat e tyre, për me mujt m'i përkrah ata, ashtu qysh edhe kishim faktikisht mundësi edhe mendoj se për aq sa kemi pasë mundësi nuk kemi kursy asgjë nga vet ne si Forum i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Pra qëllimi ka qenë shumë i madh në ato vizita, në një mënyrë edhe për m'i motivu për angazhim, për punë, për përkushtim drejt lirisë dhe pavarësisë, për m'i përkrah, për mi motivu se si duhet të rezistojnë dhe kështu me radhë.

**Anita Susuri:** Ma herët tregut për familjet që kanë humbë shumë djem edhe e kanë marrë me aq normalitet sa që ju jeni çuditë prej asaj, a mundeni rreth qasaj me më tregu?

**Ajnishahe Azemi:** A bon edhe këtë çashtje kur filloj për pjesën e angazhimit në Ushtrinë Çlirimtare?

**Anita Susuri:** Okej, po jemi te vitet '97-'98 veç jemi afru.

**Ajnishahe Azemi:** Po deshta... në këtë mënyrë pra po e shihni se kontributi i femrës kosovare, i femrës në Lidhjen Demokratike të Kosovës, po në fakt i lëvizjes gjithëpopullore në atë kohë i femrës kosovare ka qenë i madh. Prandaj, unë mendoj se këtu, tash në këtë rast ka qenë i lidhur me... pra gruaja ka qenë e kyçur në të gjitha rrjedhat e kohës, në të gjitha proceset të cilat kanë çu drejt lirisë dhe pavarësisë së Kosovës dhe kontributi i saj është i pamohushëm. Gabojnë shumë rondë ata që thojnë se luftën e bëri ky apo ai, e bëri kjo apo ajo, e bënë të gjithë qytetarët e Kosovës.

E bëri faktikisht Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e bënë të gjithë ata që u angazhuan në atë kohë, pra gratë vajzat, qoftë në Lidhje Demokratike të Kosovës edhe të tjerët, edhe të tjerët, me forma të ndryshme të organizimit. Ishte një lidhje gjithëpopullore, lëvizje gjithëpopullore që vizioni i saj, i Lidhjes Demokratike ishte në përputhshmëri me popullin dhe faktikisht ishte përkrahur nga populli dhe populli i përkushtuar i Kosovës, në kuadër të saj edhe gratë, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe në bazë të vuajtjeve të kohës ata angazhohen për të dhënë kontributin e tyre.

Nëse s'keni diçka me pyt për këtë pjesë për angazhimin e Forumit të Gruas, dhe të LDK-së dhe faktikisht unë kisha dashtë me kalu në... Për hir të respektit ndaj kontributit që Ushtria Çlirimtare e Kosovës e ka dhënë për hir të Adem Jasharit, familjes tij dhe gjithë atyre që u flijuan dhe gjithë atyre që kontribuan që Kosova sot të jet e lirë, e pavarur. Ta përmbylli këtë kapitull me këtë pjesë (buzëqesh), po para se të fillojmë më këtë pjesë, nëse më lejoni unë kisha folë diçka edhe për familjen time.

**Anita Susuri:** Po, vetëm fillimisht, para se të kalojmë te lufta, domethonë jonë... edhe pak po folim për aktivitetet...

**Ajnishahe Azemi:** Po, patjetër.

**Anita Susuri:** Ju më tregut domethonë për pjesën që i keni vizitu familjet doni me folë kur të kalojmë te lufta.

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Por para kësaj te këto angazhimet e Forumit të Gruas, shpeshherë të gjitha kanë përfunduar te zyrja amerikane që ka qenë, a keni marrë ju pjesë ndoshta në bisedë brenda?

**Ajnishahe Azemi:** Po, në zyrën amerikane...

**Anita Susuri:** Na tregoni për qato pak.

**Ajnishahe Azemi:** Në zyrën amerikane na kanë pranuar, tash s'jam e sigurt 9 vetë apo diçka tjetër, që kemi hy. Na i kanë dëgju kërkesat që, tonat që ishin dhe pse i organizum këto, këto protesta dhe ishte një shprehje faktikisht e tyre me shumë respekt na dëgjuan. Ishte edhe një pamje qëndrimi i tyre i fortë,



një lloj përkrahje ndoshta jo edhe publike e organizimit të protestës. Që në një mënyrë apo në një tjetër, se fakti që nuk po të kritikon se po e bon apo diçka tjetër, shumëçka tjetër, të jepte me kuptu se ndoshta si politikan i një shteti demokratik ndoshta i kanë pasë ata mekanizmat e vet se si ato qëndrimet e tyre t'i, t'i shprehin, t'i paraqesin. Po ni respekt patën shumë të madh për neve edhe thjesht une jom kon e mendimit që ishte respekti aty që na boni, ishin të gjitha ato gra se aty nuk kena mujt të gjitha me hy. Dikush ato kërkesat tona po na përkrahë po në momentin kur ata shohin të arsyshëm e shprehin, ashtu edhe qysh e shprehën. Dashti fati që ta kemi gjithmonë ni shtet aleat, ni shtet permanent që na ka përkrah edhe po na përkrah.

## Pjesa e Katërt

**Ajnishahe Azemi:** Unë siç ju thashë edhe ma herët kam qenë e kyçun në të gjitha aktivitetet që i theksova më parë. Por, për hir të respektit ndaj të gjithë atyre që kanë kontribuar, po flas ndoshta edhe në një mënyrë ma të përgjithshme. Mirëpo, ju thashë, po e ceku një rast që thashë se “Bën mirë në mal se e gjen në shtëpi”. Ishte ajo kur një herë me një shoqen time aktiviste, siç ju thashë e kishim përgjegjësinë, ishte koha kur faktikisht ishim pa pagesë na edhe populli ishte në gjendje shumë të rënduar. Shkuam t'i vizitojmë siç thashë, me qëllim që t'i shohim nevojat e tyre dhe çka na mujm me bo si Forum.

Ishte ditë e dimrit, ftohtë i madh, po shkojmë te ajo familje, trokasim në derë, na dalin gruja me fëmijtë, kur dalin fëmijtë {shikon këmbët e saja} krejt dathën, do pantolla të shkym, dathë dolën jashtë aty. Të veshun me gjana që as afërsisht nuk ju plotëson nevojat që ata me ndi veten komod, me u nxe tamam si duhet. Po edhe të mbathurat e tyre ishin ato që... dathë, pa çarapa dhe jashtë dolën vetëm me ato të mbathura, çizme {përkulet dhe prek këmbët e saj} të prera atje poshtë, të dala, edhe të shkyme bile jashtë.

Dhe ajo thjesht që na boni aty... dhe në një mënyrë apo një tjetër po ja boj asaj grusë {lëviz kokën} me sy, “Hë?” {ngrit supet} Me krih që domethonë, “S’kom!” Edhe tjetër i them asaj shoqes, “Hajde po kthehemi, të shohim në ndërkohë”. Kthehem në shtëpi, dhe ajo në shtëpinë e vet dhe gjatë gjithë rrugës them, “Qysh me ja bo me ndihmu atë familje? S’paku sa kemi mundësi na”. Për me qenë ma urgjente shkum nëpër shpia tona me marrë çka kishim mundësi. Çka kishim, as ajo nuk ishte në gjendje të mirë ekonomike, as na. Dhe hy në shtëpi, trokas, dalin vajza edhe djali i madh aty te dera edhe, “Hë nonë, erdhe a?” “Po erdha, po të lutem shko bimi çizmet e juve”. “Ani, nanë qe. Do me ja çu dikujt a?” “Po”.

Unë e dija që kur bëj kërkesë e dijnë ata vet se ishte e premte, e të hanen qysh me shku në shkollë, dhe, “Ama këto, ama këto”, e disha ato që i kishin, çka patëm mundësi, edhe ajo shoqja çka pat mundësi me çu atje. Ju them që, “Ishin do fëmi që as çorapa nuk kishin dhe du me ja u çu”, “Ani nonë, meniherë. A po don edhe këto, a po don edhe këto? A po don edhe kët’ jakne” apo çka kishin të veten ata. “Ani se na tek jemi në shpi”, “Në rregull”, i murrëm ato edhe i çum. Jo që ja u kemi plotësu nevojat, po në anën tjetër si e ndiejnë ata vetën, çka do të bojnë të hanën në shkollë, qysh me shku. Pare s’kishim.

Të nesërmen dolëm në aktivitetet diçka kishim edhe shoku kish dalë në aktivitet se edhe ai ishte në aktivitet. Edhe kur kthena në shpi, kthena para shokut edhe trokas në derë, po në ndërkohë dalin ata, djali, djemtë edhe vajza edhe thonë, “Nonë a erdhe a? A e din që XY na kanë pru...” nuk po më kujtohet, për një të afërm tash, qetash s’po më kujtohet, më vjen keq që s’po më kujtohet. Ni jakne edhe tha, “Na kanë lanë paret sa me ble çizmet”, tha, “Merri paret e del e blejna çizmet për të hanën me shku në shkollë”. Fakti që kanë reagu ashtu se ai nuk i’a ka dediku, se nuk e ka ditë a kanë çizme ata, a s’kanë çizme, po këta tu i mbajtë në mend çizmet se qysh me shku në shkollë atje.

Ata meniherë sikur kishin bo dedikim, dedikim të cilin edhe unë e kisha bo se thojsha qysh e kanë ndi vetin kur e din që s’kanë deri të hanën, pare s’ka. Dhe në një mënyrë i mora ato pare mrenda dhe shkova ja u bleva ato çizme, m’u duk sikur atyre ju bo, “Eh tash mujna me shku në shkollë”. Ishte sikur thjesht m’i pasë porosit. U mundova me ja u ble të njejtat, të ngjashme, të njejtat ato që me ja u plotësu ato, faktikisht një nevoj, prandaj edhe e qujta atë, “Bën mirë në mal se gjen në shtëpi”. Dhe ajo ishte një diçka që faktikisht gjithëherë më bon me kujtu edhe ajo figura e fëmijëve kur i mora e dola, kur erdha e i pash.

Ashtu ishte një gjendje të gjithë fëmijët e Kosovës, me përjetime të tilla, të ngjajshme apo të ndryshme, varësisht qysh ka qenë situata e familjes. Janë edhe shumë raste të tjera të cilat na i kemi vizitu, e të cilët i kemi pa në gjendje shumë të rënduar. Kemi vizitu gra të cilat kanë pasë fëmijë të vogël. Dhe ka pasë një rast në një familje kur shkurme me vizitu, aty po e shoh një gru, me një filxhan të kafes të vogël {tregon madhësinë me dorë}, të mbushur me ujë. Edhe po e përzinë po e shoh që po ja jep fëmisë. “A ujë po i jep?” “Jo, po e ushqej”, “Po e ushqen me ujë?!” Tha, “Osh! gati e treta ditë që s’kom gji, s’kom çka m’i dhanë edhe dej dhe kom pasë ka pak sheqer ja qitsha aty që me ja ndryshu shijën, e sot as sheqer nuk kom”.

Ajo e vërtetë ishte shumë e fshtirë, ishte shumë e randë, po që neve na bënte me u angazhu si të ndihmohet ajo familje. Si dhe faktikisht në një mënyrë apo një tjetër, së paku bazën elementare për ekzistencë me ju siguru atyre. Dhe normalisht edhe format e organizimit tjetër që na u desht me u organizu për me siguru, për shembull ne u detyrum si Forum i Grusë meqenëse e patëm një iniciativë, dy shoqeve të mia të aktivitetit ju thashë, “Si mujm me i plotësu këto nevoja dhe shumë nevoja tjera” që i shihnim gjatë angazhimit tonë. Qysh prej ‘90-tës e sidomos në kohën gjatë luftës.

Dhe u dashke me bashkëvepru me hulumtu ku, cilat nevoja mund të plotësohen me shoqata e asaj kohë të grave, si për shembull që ju thash Qendra për Mbrojtjen e Nanës dhe Fëmisë, Flora Brovinës, Sevdije Ahmeti, Kryqin e Kuq Ndërkombëtarë, pastaj Mjekët e Botës e tjerë. Kur i pash qato raste më patën shty me shku, te Mjekët e Botës punonte Ardiani dhe një Donika Dabishevc, punëtorë shqiptarë. Ardianin e kisha pasë nxënës dhe ata patën vullnetin me na ndihmu, po na thanë se organizimit politik na nuk mujna me i ndihmu, se i premtum na atyne, “Na nuk i marrim ato të mira materiale vetëm ja u bijmë listat e nevojtarëve, në mënyrë që faktikisht ata kur të vijnë ju t’ja u jepni gjanat”.

Dhe ata thanë, “Na si organizim po dojmë me ju ndihmu, po si organizim politik na nuk mujmë”. E qysh me ndihmu, hajde ta bojmë një shoqatë “Flaka” e patëm qujtë (qesh). Shoqatë e pa regjistrueme, pa

kurgjo veç shënonin ato, në mënyrë që na të ju çojmë ato. Dhe na sigurun pastaj, për shembull ushqim për bebe, pelena, ato mastat për bebe e tjerë. Jane shumë raste, shumë fëmijë në gjendje të ndryshme të sëmurë, e tjerë, e tjerë që kishin nevoj për shumëçka tjetër. Dhe atje shkonin merrnin shumëçka, të cilat ata ju dhanë po edhe të tjerë.

Faktikisht edhe angazhimi im në këtë drejtim bashkë me të tjerët ishte i madh. Po që nuk ishte ajo që faktikisht mendoj nganjëherë motivi për t'i përkrahur të gjitha nevojat e tyre, ishte e pamundshme m'u realizu, se rrethanat e kohës ishin të tilla, mundësitë tona financiare si Forum ishin të pamundshme. Po në bashkëveprim me të tjerët edhe njerëzit që donin ta ndihmonin lëvizjen, atëherë i përkrahim mrenda mundësive që ishin. Në këtë rast kisha dashtë të ceku që edhe kontributi im bashkë me shoqet e mia dhe bashkë me shokët e mi atje ka qenë faktikisht drejt realizimit të lirisë, pavarësisë, e tjera. Faktikisht, me një fjalë, për përkrahjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës për rezistencë.

Në fakt rrugëtimin tim jetësor ndoshta nuk mbrrija me përshkru si ndodhi se është punë e bërë qe 30 vite. Unë e theksova në fillim të prezentimit, nuk ka qenë një kontribut vetëm në një fushë, por ka qenë kontribut në fusha të ndryshme të cilat i theksova dej tash. Po edhe disa të tjera të cilat faktikisht bënin që thjesht në një mënyrë apo në një tjetër rrugtimi jem jetësor të jetë përkushtimi për çështjen kombëtare edhe për të mirën e qytetarëve të Kosovës deri tash. Ai angazhimi në këto aktivitete munet me ilustru ma së miri edhe me fakte të shumta, dëshmi të shumta, materiale e njerëz e forma të ndryshme.

Unë në atë kohë e udhëhiqja degën e parë të Forumit të Grusë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Përpos represionit serb që patën ndaj popullatës së Kosovës, atje kishim një gjendje të rënduar shumë ekonomike. Se është pjesa e cila në Komunën e Prishtinës ka qenë në gjendje ma të randë ekonomike, që e përfshin pjesën mbi hekurudhë këtu, deri te tash rruga e Vushtrrisë. Tash e kanë ndëpre diçka, rruga që shkon ka varrezat këtu, mbi hekurudhë edhe drejt në kufi me Podujevën me dymdhetë fshatra. Dhe aty kërkohej një angazhim i shtuar në shumë fusha. Po ishin njerëz bujarë, njerëz me zemër të madhe të cilët na lehtësonin angazhimin tonë.

Me qëllim që m'i përkrah ata, me përkrah çështjen kombëtare, njerëzit që ditën t'i hapin dyert, që kemi trokitë unë bashkë me shoqet e mia, që t'i hap, t'i hapin dyret për shtëpitë-shkolla. Siç e dini, në Kodrën e Trimave kanë qenë shumë shtëpi-shkolla të mesme, të cilat kanë punuar atje. Nëpër shumë shtëpi të asaj kohe, të asaj kohe dhe tash që janë. Kanë qenë edhe fakultetet dhe na u deshke t'i ndikojmë atje faktikisht që t'i përkrahim faktikisht ta bëjmë të mundshme që t'i përkrahim mrenda mundësive që kishim. Dhe atje në një mënyrë apo në një tjetër ishte ajo që në atë kohë ne organizonim me qëllim të ndikimit social, psiko-social e tjera, organizonim edhe aktivitete të lira.

Normalisht, unë me shoqe të mia organizonim aktivitete të lira, për orë letrare, ekspozita të ndryshme, e tjera, që e kishin tematikë domethonë gjendjen në Kosovë e tjera. Dhe të cilat ata i bënte m'u ndje mirë, se puna e tyre po shihet, po ndëgjohej, po respektohet prej të tjerëve. Dhe në një mënyrë e shihshe atë çfarë, qysh osht' ka e përjeton gjendjen edhe fëmija. Këto aktivitete i falenderoj në atë kohë edhe drejtorat e shkollave, atje që vepronin në "Zenel Hajdini", "Arsim Vokshi", të cilët na kanë

ndihmu shumë në këto angazhime. Po angazhimi im ka qenë, jo siç ju thashë vetëm në nivel të Kodrës së Trimave, po edhe në nivel të qytetit të Prishtinës, në nivel të Kosovës, në këto angazhime të tjera.

Faktikisht njerëz që në një mënyrë jo vetëm që hapën dyert për shtëpitë-shkolla, po edhe në kohët më të vështira të represionit serb, m'i hap dyret edhe për të zhvendosurit që kontributi im këtu në këtë drejtim ishte shumë i madh, bashkë me shoqet e mia gjithsesi dhe shokët e mi. Sepse pjesa ma e madhe e të zhvendosurëve u vendosën në atë pjesë. Dhe tash gjendja u rëndu edhe ma shumë, ekonomike, edhe gjendja e cila faktikisht bënte që të angazhoheshim dyfish. Thjesht ndoshta nëse dyfish të angazhoheshim, sepse tash përpos gjendjes që e kishim, na u shtun edhe njerëzit nevojtarë tjerë edhe të cilët kishin nevoja të shumta të natyrave faktikisht të ndryshme.

Të cilat na duhej faktikisht t'i përkrahim ato mundësi që i kishim, prandaj ajo ka qenë kur ndoshta nuk e kom ditë kur jom në shpi, nuk e kom ditë kur... atëherë veç ishte një gjendje që na arsimit shqip fillim me një masë të caktuar dhe shoku filloi me punu, nuk ishte si ajo gjendja e ma përparshme në familjen tonë. Po ishte faktikisht një kohë, kur faktikisht ndoshta s'mundja ta bëja një gjellë, ta hanin një gjellë të nxehtë fëmija mi, ndoshta mos të më shohin tanë ditën. Ka pasë rast kur me ditë të tëra nuk më kanë pa ose s'jam ardhë hiç në shtëpi, se angazhime tjera kisha shtesë që kërkonin kohë dhe mund dhe të mos jem ndoshta në shpi, të jem diku tjetër.

Të jem atje ku veprojsa si, si ushtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mos jem në shpi, të mos më shohin me ditë të tëra. Mos te gëzojnë përkrahjen time dhe ata fëmijë të pysin se, "A do të jeni, a do të jeni ndonji ditë..." meqenëse ju thashë se edhe shoku ishte në aktivitet, "Ndonjëri nesër në shtëpi apo në cilën kohë të ditës do të jeni?" Nuk ishte e lehtë as për neve që të shkoj atje që... po faktikisht të kontriboj edhe në një mënyrë u dashke edhe ata m'i eduku edhe nuk ka ndodhe ndonjherë me thonë, "Pse nuk je..." apo "pse s'na ke bërë këtë apo atë?" U dashtë me punu në atë drejtim me i mësu se kjo që po e bëj është për të mirë të gjithë popullit të Kosovës, prej të cilëve është edhe interesi i tyre që Kosova të jetë e lirë dhe e pavarur dhe demokratike.

**Anita Susuri:** Si ka ndodhë që keni shku në UÇK?

**Ajnishahe Azemi:** Unë kisha... nëse më lejoni veç edhe...

**Anita Susuri:** Po?

**Ajnishahe Azemi:** Një moment të caktuar këtu që ju thashe pak më parë. Meqenëse, fillim me folë faktikisht për angazhimet e mia në Kodrën e Trimave, faktikisht të Forumit të Gruas. Në veçanti kisha dashtë të përmendi kontributin e pamohushëm që e kanë dhanë shumë zonja dhe zonjusha. Kemi pasë përkrahjen e degës së qytetarëve të asaj pjese, po edhe të shumë zonjave dhe zonjushave që kanë qenë pjesë e strukturës që më vjen keq që s'mbrrij me i përmend të gjitha, sepse ai kontribut që kemi dhënë unë dhe të tjerët nuk kishim mujt me i bo pa u angazhu të gjithë.

Këtë rast e kisha përmen zonjën Igballe Rexha, që ishte kryetare e parë e Forumit të Grusë të asaj dege dhe njëkohësisht pastaj vazhdoi të jetë anëtare e kryesisë të Forumit të Grusë në nivel qendror me

motrën e saj Shukrije Rexhën, e burgosun politike dhe familjen e tyre, të cilat kontribuan shumë për çështjen kombëtare. E këtu deshta ta përmend rastin e nanës saj, siç e thash, kishte raste të shumta që ishim të angazhuar në aktivitet edhe këto edhe unë edhe ishin raste të shumta të cilat kërkonin që edhe natën të angazhoheshim.

Ishte koha tash, një rast ishte faktikisht kur na veç ditën kishim vepru me Shukrijen, kishim punu, kishim dalë nëpër barantore, se ish ndi nevoja për grupet ilegale të asaj kohe që vepronin. Veç ushtria kish fillu edhe ma herët, mirëpo dhe grupet ilegale të ndryshme që punonin drejt lirisë dhe pavarësisë së Kosovës me mundësitë e veta, u parashtrua nevoja për barna me ble dhe faktikisht me medikamente ose të ndryshme. Dhe na kemi organizu që faktikisht të takohemi me te Shukrinë, te shpia e saj dhe tham, “Të shkojmë, të vijmë, t’i mbledhim ato barnat”.

Falemnderit për të gjithë ata që na ndihmun edhe normalisht me gjithçka pastaj, me dokumentacione me kthy se ku kanë shku. Dhe kthehemi na në shtëpi ishte ora dy e gjys, edhe... e natës. Na shkojmë atje, thotë ajo, “Jo, s’do të shkojsh ti Ajnishah në shpi”. Se u dashtë m’i vendos ato letra, kopje krejt. “Nuk do të shkojsh atje. Unë do t’ju kthej bukë”. Bukë në ora dy e gjys të natës, “Jo, se jeni lodhë, e keni pasë frikën, këtë apo atë”. Po ajo ka qenë një gru zojë, që jo vetëm atëherë po shumë raste, shpija e tyre thjesht ka qenë e hapur për kontribut kushdo që ka dashtë<sup>4</sup>.

Ta përmendi doktoreshë Ajshe Berishën, e cila ka kontribu shumë edhe në aspektin medicinal edhe në forma të tjera. Ta përmendi Bedrije Elhamin e cila (qesh) dinte prej Rimanishte edhe në komë me ardhë për me mujt me kontribu këtu dhe kontribonte edhe atje. Po e përmendi Bedrije Sylën Kokollin, e cila pa ndërpre gjatë gjithë periudhës së para luftës është angazhuar. Po e përmendi faktikisht Selime Arifin e cila ka kontribu mjaft. Po e përmendi kontributin e Hamide Canollit, e cila ka kontribuar mjaft në atë drejtim dhe nuk dinte të ndalej.

Meqenëse na kishim si Forum i Grusë... herë unë, herë ajo, organizonim ekipe mjekësore, për me shku nëpër shpija m’i vizitu qytetarët dhe në kohën e luftës, kur filloi lufta edhe të zhvendosen nëpër shtëpi. Që s’ditëm m’u nalë kudoqoftë që ishte. Dhe të përmend Lejla Rexhën, Afërdita Veliun, Nerimane Shulemajën, Hazire Shabanin, Luljetë Shulemajën e shumë, e shumë të tjerë që më vjen keq që nuk po mbërrin t’i përmendi. Po në ato përkrahje edhe unë edhe Forumi e kemi pasë përkrahjen e bashkëaktivisteve pra dhe aktivisteve të degës së LDK-së të asaj kohe, në qendër të Kodës së Trimave. Nëse s’keni ndonji pyetje për këtë çështje, unë kisha vazhduar diçka faktikisht dhe për familjen time...

**Anita Susuri:** Okej, lidhur me...

**Ajnishahe Azemi:** Po, tash në mënyrë që të ndërliidhen, faktikisht ndërliidhen me ngjarjet.

**Anita Susuri:** Aha, në rregull. Mirë.

**Ajnishahe Azemi:** Meqenëse ju thashë që isha e angazhume në të gjitha ato aktivitetet e sipërpërmendura, angazhimet dhe angazhimi faktikisht i imi në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ishte që thjesht koha siç thashë ma përpara mos të jem në shpi shumë. Thjesht nganjëherë pytem, dhe të tjerët

më thonë se, “Ajnishah si ke mrri me qenë këtu? Qysh ndoshta edhe të ka duru familja?” Po ç’të bëj, ishin nevojat e kohës dhe përkushtimi që me kohë e kishin ditë. Dhe kontributi i pamohushëm që bashkëshorti në vazhdimësi, prej fillimit Azemi ma ka dhonë. Sepse ai vet ishte aktivist i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ai ishte edhe... babën e ka pasë deputet të Kuvendit të Kaçanikut. Dhe kishte përpos aktivitetit në LDK, rreth familjes që ai ma tepër u deshke të merrej me ta. Dhe ishte faktikisht ajo se ishte i angazhuar rreth... se baba i tij nuk doli në ekzil në atë kohë, prandaj u deshke me siguru përshkak të qëndrimit ilegal këtu nëpër Kosovë tek të afërmit, miqtë, dashamirët e tjera.

Dhe kështu që, prej fillimit faktikisht edhe fëmijtë e mi, e kom pasë ni përkrahje shumë të madhe prej tyne, prej fëmive. Ata qysh të vegjël i kom lonë siç e thashë ma përpara, vetëm - se të dytë ishim në aktivitet - të kujdesen për njëri-tjetrin. Situata u rëndu ma shumë atëherë kur, para okupimit të Radio Televizionit të Prishtinës për shkak të diferencimit të asaj kohe, e larguan bashkëshortin prej pune dhe mbetëm pa njërën pagesë. Por nuk u ndi ajo mungesë, meqenëse ende ishte njona pagesë. Dhe pagesa tjetër kur u ndal, e imja, ishte ajo që faktikisht na pruni shtesë vështirësi. Tash si të sigurohet ekzistenca e familjes dhe që e rëndoi gjendjen edhe ma tepër, siç e thashë ma përpara, se nuk e dije për shembull, sot e ki një kafshatë buke, nesër s’e ki.

Po, i falenderoj shumë të gjithë ata që na kanë ndihmuar që në gjithë atë kohë, ato vite me na përkrah e të mbrijmë të mbijetojmë, ta kalojmë atë situatë. Tu u nis prej prindërve tanë, prej vëllaut tim, prej dy motrave të mia, prej të afërmëve, prej miqve, prej aktivistëve në forma të ndryshme që nuk kursenin asgjë për me na ndihmu me ato mundësi që kishin. Përkrahje, siç ju thashë kemi pasë të madhe edhe prej, edhe që ju thashë qoftë gjatë studimeve ju thashë më kanë përkrah, por edhe tash si familje edhe prej tezës time.

Që ju thashë që ishim bashkë në një familje, që ka qenë e martuar me djalin e axhës të babës, prapë një familje që kemi qenë atëherë, po tash ndërkohë edhe jetonte në Prishtinë. Prej kohësh që ka qenë i burgosun politik, që atëherë sa herë unë nuk kom pasë pare, kom shku gjatë studimeve me qenë te ata, Hamza Shala dhe tezja Fata. Po edhe tash mrena mundësive që kishin, me forma të ndryshme na ndihmonin, por edhe të afërmit e tjerë edhe aktivistët, aktivistet që na ndihmuan, se nuk ishte e lehtë ajo për neve dhe për fëmijtë tanë.

Po ju tregoj edhe në aspektin e ndjeshmërisë ndoshta psikologjike, sociale dhe ndoshta tjera, dy raste. Edhe për bashkëshortin po edhe për fëmijtë. Në një rast unë kisha me dalë në aktivitet, po në të njëjtën kohë kisha edhe shokun me veti. Dhe në anën tjetër, ai doli në ato format e mbrojtjes, kjo është ngjarje kur ka ndodhë në format e angazhimit për vetëmbrojtje që kanë qenë. Dhe kisha përgjegjësi me dalë dhe, ai e dinte që une kom me dalë në ora 23:00 prej shpije, të natës dhe kom me shku në aktivitet. Dhe unë dola, fëmija mbetën vetëm. Dhe unë nuk e dija se do të kthehet ai në atë kohë, po ai e dinte që unë kom me dalë, ai kish përfundu pune atje dhe po vinte.

Por, në ndërkohë gjatë rrugës e takoj një të afërm të vetin, që më vjen keq, nuk po e përmend se s’du të bohem si ai, dhe pse (qesh) si i tillë ai i ka shfrytëzu këto institucionet e Kosovës pas lirisë mjaft me pozita të ndryshme. E që, do të vjen koha që do t’ja them, në këtë rast jo, nuk është për vete po për interesin e shoqërisë, cilët janë ata që po përfitojnë apo cilët janë ata që kanë kontribu deri këtu si... E

takum atë, dhe e kish taku ai dhe unë u takova me ta tu shku rrugës. Dhe në moment kur u afrova ngat ja bon burrit, “Çfarë burri je ti që e len grunë me dal në ora 11 natës? Dhe në shumë raste kthehet në dy të natës, apo s’vjen hiç në shpi atje”.

Tha, “Çka je ka thu? Prej ka jom ka vi vet?” Tha, “Unë krenohem me atë çka bën. Nuk e di a jem ka e bojmë të dytë atë që kërkohet dhe duhet, që është e nevojshme” dhe më tha, “Punë të mbarë!” (buzëqesh) Unë veç u ndala {bën sikur shikon me habi} po e shiqoj. Tha, “Kuku” tha, “A qishtu koki bo?” “Po une e kom ditë prej kohësh që faktikisht çka jemi ka bojmë të dytë edhe mrena mundësive tona çka kemi na si individë, si familje me kontribu çështjes kombëtare dhe të mirës qytetarëve”. Rasti tjetër është... kjo ka qenë ma e rondë se prapë ai njeri i pjekun po fëmijët e vegjël. Dhe ata e kishin dritaren e hapur, unë sa dola prej shtëpisë e takoj t’u dalë një gru.

Ndoshta pak që, nuk është për me theksu po ajo është diçka që individë të caktuar mendonin për ne femrat apo të tjera dhe aty fëmijët na dëgjonin krejt çka po folim. Dhe tha, “Çfarë nane je ti që po don me i lonë fëmijtë jetima. Po i len vetëm kështu dhe del për tjerët me nga?” “Çka je ka thu? Po unë nuk...” “Je ka don me lonë fëmijtë jetima”. Thashë, “Po edhe këta do të rriten nëse ndodh ajo, le të rritën si fëmijtë tjerë jetima të Kosovës, se i kanë ata që punojnë dhe i përkrahin këta sepse një ditë këto gjana, kjo dhunë, është ajo që nuk do të jetë. Dhe do të jetë një ditë, një e ardhme ma e mirë edhe e këtyne në kuadër të gjithë fëmijëve tjerë”. Tha, “Uuu {onomatope} mjerë ata fëmi!” Ata e dëgjojnë krejt.

Edhe unë vazhdova me shku, kur u ktheva tha, “Nanë çka tha ajo gruja? Uuu {onomatope} çfarë gruje, çka po menon ajo ashtu? Na po e dijmë që je ka bon për të mirën e krejt neve, ato çka munesh me bo. Edhe nanë” tha, “na në këtë mënyrë që s’po dojmë me bo probleme, e mos m’u ndal, me ndejt vetëm, po mundohemi m’u angazhu, me mësu. Po mundohemi në një mënyrë apo në një tjetër edhe na me kontribu në atë mënyrën tonë me qaq sa po kemi mundësi”. Përkrahës i kom pasë në mënyrë të vazhdueshme sikur edhe sot që i kam.

## Pjesa e Pestë

**Ajnishahe Azemi:** Nëse s’keni pyetje kisha me kalu me... e bot’ ni pyetje, si ndodhi që të angazhoheni...

**Anita Susuri:** Po...

**Ajnishahe Azemi:** ...në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ku jam veterane e zonës operative të Drenicës. Dhe ish ajo se me shoqet tona të aktivitetit si Flora Brovinën, Hanumshahe Ilazin, Fatime Berisha, e shumë të tjera që ishin në aktivitet, që më vjen keq se s’po mrrin me i përmend. Shokët, Agim Avdyli, Nebih Balaj, Haxhi Prengun, Rifat Bejtën e shumë të tjerë. Tu i pa nevojat e kohës, tu e pa gjendjen edhe presionin serb ndaj popullit të Kosovës. Tu e pa se populli Kosovës ndoshta po kërcënohet, përpos represionit edhe forma tjera edhe shfarosja, e pamë të udhës të vazhdojmë e angazhohemi në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Ishin shumë... tash po ndalem, nëse mendoni se faktikisht në raste të caktuara tu e pasë bindjen se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka për qëllim udhëheqjen me komandantin legjendar Adem Jasharin, po e zhvillon një luftë faktikisht të pastër, një luftë për të mirën e popllit të Kosovës, për lirinë, pavarësinë, na vendosëm që të kyçemi, që të kontribuojmë në atë drejtim që edhe aty pra edhe shumë angazhime tjera se ishte fat i mirë që unë e njihsha gjendjen. Ishte aktivitet i gjatë me këto shoqet dhe ajo bëri që ta njihnim mirë. Kishim mundësi edhe e pamë të udhës se mundemi me kontribu edhe ka nevoj me kontribu në atë drejtim dhe u kyçëm.

Po i përmendi disa raste që ishte nevoj vetëm e sakrificës, faktikisht për veti dhe familje, po përgjegjësia për mënyrën e kryerjes faktikisht aktivitetit ishte, duhej të ishte shumë e madhe. Për arsye se ti me angazhimin tond ndoshta mund ta përkrahësh aktivitetin, e mund ta përkrahësh popullin, mund të bëje edhe keq se ndoshta të kuptojnë ata prej regjimit serb se kush çka po bon, apo si po vendoset. Këtë po e ndërlihi me një rast kur ishte plagos një ushtar dhe ishin rastet e para. Dhe dikun faktikisht më thërret doktoreshë Flora Brovina, thotë... na i kishim edhe do kode tona (buzëqesh), qysh me u kuptu po edhe një mënyrë tjetër që thotë se, “Ka ardhë ushtari i parë është në gjendje shumë të keqe të lënduar, shëndetësore”.

I kanë çu atëherë në ambullantën “Nëna Terezë” se vepronte aty afër shkollës “Zenel Hajdini”, e kanë dhonë ndihmën që kanë mujt ata edhe e kanë vendos në një shtëpi aty shumë afër. Dhe ai jo që s’ka kushte aty, se aty mrena nuk kanë guxu për shkak, a, të regjimit serb se mos po e kontrollojnë pastaj rrezikohet puna faktikisht e shoqatës “Nëna Terezë”. Për të cilën punë kishte nevoj, ka pasë edhe kishte nevoj poplli i Kosovës, dhe kontributi madh jepej. Dhe thotë se, “Mrenda gjysmë orë” thotë, “ai të hiqet prej atyhit”. Për arsye se munet me u kuptu, faktikisht ka kërcënime që ka informata policia se shoqata “Nëna Terezë” po e përkrah edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, dhe aty rrezikohej sistemi shëndetësor në atë kohë.

Thotë, “Duhesh me hek prej atyhit”. Unë çfarë të bëj? Kerr, veturë s’kisha dhe tha një diçka, tha se, “Ti në shtëpinë tonde...”, atëherë i kom pasë dy dhoma të vogla, e tjera, tha, “...nuk bon me e marrë”. Se menjëherë ju shkon menja që e marrë aty, ndihma e parë dhe thotë se, “Ti e dinë që je në aktivitet edhe një format munët m’u kontrollu edhe prapë munësh me rreziku. Mundohesh me bo mirë e ban keq”. “Në rregull doktoreshë, po shiqoj çka muj me bo”. E thërras një shoqe dhe shkon te një i ndjerë tash, osht’ Smajl Krasniqi, jo shumë larg shtëpisë time dhe i tham, “Baca Smajl...” ka qenë pak ma i vjetër se unë, sa mujsha me thirrë, “kom ardhë për ni arsye”. “Hajde Ajnishah mirë se ardhsh, s’ka problem”.

“Me kërkun përkrahjen tonde po kjo osht’ për ni aktivitet, për ni të mirë që po kërkuj prej jush, që unë për veti s’po muj me bërë po që ka nevoj m’u bë se ka rëndësi shumë”. Tha, “Çka osht’ ajo?” i thashë, “Kështu, kështu, kështu, u plagos” këto që mos t’ju marrë kohën, ju tregova. “Dhe mu më duhet atë me e hek prej aty se rrezikohet sistemi shëndetësor i “Nanës Tereza”. Tha, “Po bacit, bjere këtu te na”, “Ani”. Edhe tash unë deshta me u largu, kur më thotë, “E me çka do ta bish ti?” Se ai e dike se na s’ishim larg me shpija. Thotë, “Ti veturë s’ki”, “S’kom, po, nuk e di”. E di që më thotë Zoti ndoshta për



momentin më ndihmon, tha, “E di pse e ki këto, ndoshta pak po ndjehesh në siklet se qenka çashtja që mos të rrezikohet”. “Po është edhe ajo”.

Thotë, “Jo, qe unë do t’i them” për djalin e vet, “Dhe veturën e tij do t’ua japi, që bashkë me këta, me djalin me veturë të shkoni ta merrni”. Edhe ata e kishin një kamion e tjera. Dhe bëmë disi që ndonjeri të shkon me një, në mënyrë që nëse dikush lajmëron diçka me njonin mundemi dika me ikë dhe, “A ki kon tjetër me marr?” Thash, “Jo, bashkëshortin Azemin”. E mora edhe atë dhe bashkë me të edhe shkum atje e morëm. Kur shkum me pa në çfarë gjendje ai, thjesht s’di qysh s’i kishin dalë zorrët krejt. Ata ja kishin dhonë ndihmën e parë, me ato mundësi që i kishin pasë. E morëm atë rast edhe dolëm. Po gjithëherë me frigën {shikon mbrapa}, se tash mos po na zojnë me atë e po kujtojnë që osht’ ushtar edhe po rrezikohet sistemi, e prumë.

Dhe ajo familje i hapi dyert për të, thjesht ushtar që është i plagosur dhe e mbajti me shumë kujdes, me shumë përgjegjësi se ajo osht’ edhe ni rrezikim i familjes vet. Sepse aty u desht edhe në ora të natës të thirrin, “Osht’ ka don me vdekë, osht’ shumë keq! Bon diçka!” “Çka me bo?” Thotë shoku, “Unë po shkoj ndihmën e parë me marrë, me thirrë dikon te ndihma e parë”. Se për ndihmën e parë ti u deshke me gjetë dikon që e njeh, që e din që i beson. Edhe, “Kon?” Thashë, “Shko në shtëpinë, këtu, këtu” edhe kërkum, ku shkon sikur me dasht Zoti me të ndihmu. Edhe del njena prej aktivisteve një Xheki ka qenë, që na ndihmonte mu e Florën në aktivitetin. E gjejmë aty thotë, “Çka?” “Qishtu, qishtu”, “Po,” thotë, “qe po vi”.

“Po qysh del prej pune?” Se u deshke m’i dhonë ato gjonat që ishim mjekësore, s’di unë çka ishin ato nevoja, që mundte me i përmbush edhe ajo. Edhe thotë, “Po”, “Po, qysh arsyetohësh?” “Jo, be i thom, ‘Erdh djali dajës e pasna nonën smutë, po shkoj’, ku e dinë ata”. Edhe aty ja dhamë ndihmën e parë, po ajo shpi u desht se, ajo zgjati shumë se ai ishte keq, me frekuentu mjek të ndryshëm, në forma të ndryshme edhe shumë herë ka mujt me ra në sy të faktikisht forcave okupuese të asaj kohe. Po ka dashtë Zoti kanë shpëtua mirë, po kanë kontribu shumë dhe është ajo që kanë ndihmu.

Rasti tjetër që ma kërkut atje, kur kemi shku me Florën, Hanumshahen, Fatimen e të tjerë, ajo ishte për neve ni diçka që e kishim përgjegjësi tashmë, që të punojmë në aktivitete psiko-sociale, në përkrahjen e asaj popullate, faktikisht me veshmbathje. Faktikisht edhe përkrahje spitalit ushtarak, pastaj edhe në Likoc me medikamente. Pastaj përkrahje të tjera që duhej që ndoshta nuk kishin mundësi në shtëpi të tyre, për përkrahje shëndetësore apo që thashë psiko-sociale përkrahje e tjera. Vizitonim, vizitonim... mund të quaj ishin pjesë të aktiviteteve dhe detyrë, përgjegjësi të shkojmë t’i përkrahim popullatën si pjesë e angazhimit.

Dhe mes tjerash që ju thashë, shkum në familjen faktikisht Sejdiu kur le baba Sheremeti, po nana Abidja flet për katër djemtë të varrosun, faktikisht të vramë dhe flet në atë mënyrë që të bënte të kuptosh që është ni gru e fortë, ni gru... “I kom dhonë djemtë për liri” thojke. “Fati ka dashtë që këta të shkojnë” qëndronte, ni gru me të vërtetë e fortë. Jo, pse faktikisht po them se ajo me habiste, katër djem, edhe ishte ajo... ose rasti, për shembull në familjen Rexhepi, kur vajzën aty, Shota e ka pasë emrin, edhe e ka, sot është e rritun. Atëherë, na herën e parë kur shkum, ishte dy javëshe. Po çka ka

qenë, pse po e theksoj, se ajo e pati fatin që veç kishte lind para dy jave, mirëpo ni ditë përpara kishte ardhë në shtëpinë e vet dhe një natë i kish ra me babën me qëndru, nesrit baba ju vra, gjyshi.

Edhe ishte ajo që faktikisht ishte disi rondë, si e shihshe atë vajzë. Të shkoje për shembull në familjen Seferi, siç ju thashë edhe ma përpara, shkum atje dhe kur shohim atje që përpos tjera që mos t'i përsëris ato gjëra, kur shkum te vendi, te dhoma ku është vra gruja shtatzanë ishte shumë e fshtirë me e pa ate. Kur e shihshe gjakun nëpër mure e në dysheme, faktikisht tashmë ish tha po kishin mbetë njollat. Dhe fëmitë që ishin mbetë jetim aty rrishin te na dhe nuk qanin. Gjaku i nonës *kuhhh* {onomatope}, ishte shumë e randë, shumë e fshtirë që thjesht edhe tash po më bon m'u ndi shumë keq, se ndoshta po e bojnë edhe emocionet të veten. Ju kërkoh falje.

**Anita Susuri:** S'ka problem.

**Ajnishahe Azemi:** Se nuk po muj me ju tregu krejt atë që e kemi pa, e kemi ba, jemi përkushtu. Se janë ato të pamundshme se 30 vjet punë, sakrificë, kontribut i vetes, familjes, shoqërisë e tjera. Mirëpo... desha ta përmend Ganimete Zelën, kur ajo bashkë me vjerrin e saj, burrin e saj, e tjerë janë gju prej forcave policore. Kjo ka qenë ajo ngjarja, 8 shkurt, 1 mars e tjera, në Likoshan edhe në Çirez, se këto nuk janë shumë larg. Të shohësh aty qysh për shembull fliste, kur thotë se qysh ka mbrri me shpëtu, kur ka qenë me breshëri plumbash, është gjujt shtëpia tyre dhe ka pa që burri ju ka vra edhe vjerri.

Thotë qysh ka mbrri bashkë me fëmitë e saj, tregon që u afru afër banjës, atje për me ikë, se ata gjunin në pjesën e përparme të shtëpisë e tjera dhe "Deshti fati që unë të shpëtoj më fëmijë". Flisnin në mënyrë që kishte edhe dhimbje për humbjen e bashkëshortit, po edhe ndoshta ni, ni, ni qëndresë për atë se i ka fëmitë dhe i ka shpëtu edhe fëmijët. Ajo vërtetë u shike se është një gru që vërtetë qëndronte mirë në krahasim me vujtjen, dhimbjen që e kishte.

Ose të shkojë në familjen Ahmeti, kur shkum, ishte ajo kur qysh ato gra, ata vëllezër që kishin shpëtu, ata fëmi, flisnin tregonin ngjarjen që ishin zhvillu aty, si qëndronin, si flisnin. Me të vërtetë jemi popull i fortë, kemi edhe fëmi të fortë, rini të fortë. Se m'i përjetu ato gjana edhe m'i tregu, me qëndru ashtu të fortë osht' shumë e fshtirë, po vërtetë jemi popull i fortë. Prandaj, mund të them se këto e shumë e shumë angazhime të tjera, ose të shkosh për shembull, kur kemi shku në Baks, në një familje ku... kjo osht' pak edhe e ndjeshme shumë.

Ni plak, ni plakë, tash nuk e di sa vjet, po të moshum mund t'i quaj. Afër e kishin aty një djal të vajzës, djalin ja u kishin mytë, i cili e kish pasë edhe ni muj m'u martu, vadën e ndame dhe ai ishte ai që do të... ata e kishin pasë gjithmonë si përkrahje se e kanë qat' djalë dhe i përkrah dhe do të mbushet shtëpia, dhe ata mo veç e kishin humbë. Apo shumë e shumë raste të tjera që vërtetë nuk e di, a kemi mujt me ndihmu sa kemi pasë mundësi, po mendoj se nuk kemi kursy kurgjo, as unë, as shoqet e shokët tanë të angazhuar qoftë në luftën çlirimtare, po edhe të tjerët për me ndihmu. Jo, vetëm këto raste që i përmenda por edhe të gjithë qytetarët që kishin nevoj për përkrahje në forma të ndryshme.

**Anita Susuri:** Kur ka qenë koha që keni shku ju në UÇK, në cilin muj?

**Ajnishahe Azemi:** Filimi i janarit '8... faktikisht ishte '98 dhe deri në përfundim të luftës.

**Anita Susuri:** Cilat kanë qenë rastet ma të këqija që jeni përballë?

**Ajnishahe Azemi:** Po, ju thash janë raste të shumta. Janë raste të shumta të cilat faktikisht...

**Anita Susuri:** Edhe ku keni qëndru gjatë asaj kohe?

**Ajnishahe Azemi:** Kemi qëndru ku ka qenë nevoja, kemi qëndru ku ka qenë nevoja. Dhe ju thashë që atëherë nuk e kemi ditë se ku e kem faktikisht mundësinë me qëndru, po gjithëherë në gjendje gatishmërie për angazhim, për përkushtim, natë a ditë a, vendi s'është pytë. Ju thashë ka ndodh me ditë të tëra që s'kemi qenë në shpi. Ka ndodh që fëmija s'të ka pa, familja s'të ka pa se s'ke qenë në shtëpi, ke qenë në aktivitet, në angazhim të caktuar. Dhe nëse i ndaj të gjitha ato që kemi qenë janë të shumta, se s'kemi ditë as çka, cilin me vizitu po janë të shumta ato.

**Anita Susuri:** A keni pasë armë apo?

**Ajnishahe Azemi:** Jo. Armë jo, po ju thashë se, unë në fillim i prezantova ato që kanë qenë, ato aktivitetet tona psiko-sociale. Përkrahja me veshmbathje, përkrahja me medikamente, me ekipa mjekësore nëpër familje, nëpër terren, qoftë këtu në Prishtinë, qoftë, faktikisht atje në Drenicë, se ishin ata nevojtarë. Kemi vizitu shumë e shumë fshatra, shumë e shumë familje, për aq sa kemi pasë kohë. Po them edhe këtu në Prishtinë kemi organizu ekipe mjekësore të cilat... thashë edhe ma herët Violeta dhe Skender Zatriqi, doktor burrë e gru. Me veturën e tyre, me shpenzimet e tyre, ata vinin aty ku kërkohej që të shkonin, se këtu është nevoja, këtu është ky smutë, kjo e ka këtë nevoj.

Dhe ju thashë edhe ekipe të tjera kemi pasë mjekësore dhe të cilat i organizonim me shku, me i vizitu. Mrenda mundësive ku kemi ditë që ka nevojtar dhe kërkojnë ndihma, faktikisht mjekësore. Më vjen keq që s'po muj me i përmend se vërtetë ka kalu një kohë. Kam shumë sene që i kam të shkruara, po të cilat unë nuk e pata rastin as që t'i shfletoj, faktikisht të ja kthej kësaj. Prandaj, nuk po di a cilat me i cekë se janë të shumta këto angazhime.

**Anita Susuri:** Deshta me folë për kohën kur kanë fillu bombardimet...

**Ajnishahe Azemi:** Po...

**Anita Susuri:** Se në fillim ka qenë një gëzim.

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Por pastaj ka fillu gjendja, domethonë totalisht është shkatërru. Ku keni qenë ju edhe si e keni përjetu atë moment?

**Ajnishahe Azemi:** E ajo ku kom qenë unë, ka qenë, kemi qenë (kollitet), kërkoj falje, të vendosur te tezja e burrit, në Kodrën e Trimave. Sepse neve aty ku jetoja une në atë kohë, në prag të fillimit të bombardimeve ishim vetëm dy shtëpi aty. Po, dy shtëpi. Jo, kërkoj falje tri shtëpi, në të cilat njerëzit që kishin qëndru, kishin dalë. Ato shtëpi ishin të mbushura plot me njerëz që kishin ardhë. Dhe aty afër në një shtëpi ishte vendosur ushtria serbe, të cilët në një mënyrë apo në një tjetër faktikisht i kishin lajmëru institucionet tjera që nëse na sulmon, faktikisht, apo diçka tjetër, i kemi ata qytetarët e thjeshtë. Që ndoshta ka pasë shumë, shumë, nuk e di tash sa kemi qenë po të mbushura ato shtëpi.

Edhe në ndërkohë çka u prishën interesat e tyre, apo ku ta di njeri, e tjerë, janë ardhë edhe na kanë dëbu prej shtëpive. Edhe dëbimi prej shtëpive ishte një fakt se na, faktikisht, ishte ajo që e dishim që na çojnë dika. Mirëpo, si rezultat i asaj që na terrenin e njihnim edhe unë edhe bashkëshorti, dhe na faktikisht, deri në momentin kur faktikisht na përcjellën atje me hy në ato kolonat për format e ekzilit, na në një formë me bashkëshortin e kuptum pa e diskutuar se këtu po ndahemi edhe mujm, mujm me kalu që mos me shku. Se s'dojshim me lëshu Kosovën, se ishim betu se s'dojmë me lëshu Kosovën.

Na ishim që dilnim në terren {drejton duart kah vetja} dhe kërkonim mos te lëshonin Kosovën se këtë e ka qëllim Serbia, dhe tash na vetë të ikim. E shihnim atë si jo vetëm pse po dalim ne, po në një mënyrë edhe popullata që të mos zhvendoset se ata që na njihnin, “Këta po dijnë diçka meqenëse janë në aktivitet, se osht’ rrezik i madh prandaj edhe po dalin”. Duhesh me pasë përgjegjësi se çka aktiviteti yt, faktikisht si po ndikon te popullata. Dhe na kemi dalë atynve rrugëve në forma të ndryshme, që i dishim edhe kalum, shkumë te një shtëpi, faktikisht atje ku ishin vendosur do djem të axhës së tij.

Dhe atë natë faktikisht... Jo, kërkoj falje, domethonë prej aty na kalum dhe shkumë te djali i dajës burrit, afër shkollës “Zenel Hajdini”. Kur shkuam atje, ai... ka qenë edhe qeky rast me e përmend, ka qenë shumë i dhimbshëm. Del zonja thotë, “Ajnishah, hajde”. Dhe e shoh me shami të bardhë në kokë, edhe krejt ishim aty, bashkëshorti, baba i burrit, vjehrra, fëmija, tonë. Thotë, “Ma kanë vra Qëndresën” ishte ky rast në Makovc {tregon me gisht djathtas} kur jonë bo ato vrasjet atje e tjera. “Ma kanë vra Qëndresën” thotë, kështu, kështu, e tjera. Edhe thotë, “Plot e kemi shpinë” njiqind e kusur njerëz.

**Anita Susuri:** Qendresa, vajza ka qenë e...?

**Ajnishahe Azemi:** Qendresa vajza, ju thashë në pjesën {tregon me gisht djathtas} e Makovcit, tash ata janë të varrosur në Makovc atje. Edhe na jemi kthi, po aty hymë, plot shpija, nejtëm sa nejtëm. E burri i tezës Xhelili, të shokut, ai tha, “Ejani do të shkojmë te na” dhe na kemi shku atje dhe na aty kemi qenë kur kanë fillu bombardimet. Ka qenë një gëzim i madh, mirëpo ka qenë faktikisht edhe një frikë e madhe, një frikë e madhe se faktikisht simas informatës, tash nuk e di sa ato kanë qenë të sakta e tjerë. Se e kanë rrethu Kodrën e Trimave, meqenëse po e dinë që jane vendosë shumë njerëz dhe kanë maru do gropa të mëdhaja, në të cilat kanë me masakru qata qytetarë që i gjejnë se kanë qëndru këtu, se janë ata që s’kanë dashtë me lëshu Kosovën, kanë dashtë me qëndru.

Ajo nuk ndodhi për fat të mirë, faktikisht se hyn forcat e NATO-s, i pritëm shumë mirë. Po qajo gjendje që përfiltej deri sa nuk ishe i sigurtë që faktikisht a osht’ e vërtetë a jo edhe nuk ishin të sigurtë me shku në shtëpinë tonë, apo diçka tjetër. Pritën shumë mirë, po në një mënyrë deri sa fatikisht u sqarua

gjithçka ishte jo e lehtë. Se kur i ndishe ato zhurma, ato flake, ata si në një mënyrë festojshin, e festojshin këto faktikisht. Jo, kërkoj falje, bombardimet kanë qenë aty shumë keq kemi qenë, kërkoj falje, po kjo është faktikisht në një mënyrë... Keq jo, kërkoj falje, se m'u ka ngatërru këto, kërkoj falje.

I pritëm shumë mirë se ndërkombëtarët po na përkrahin. Mirëpo, që ju thashë, tash qaty erdha se në anën tjetër, ajo shtëpi është pak si në kodër, anën tjetër fillun faktikisht këto tjerat në forma të ndryshme dhe çka do të bohet me neve tash e tutje. Po prapë ishte ajo e mirë se po e shohim që bota ndërkombëtare po na përkrah, pra sa mundet dhe e pritshim se domethonë, rinia e Kosovës po vjen. Dhe prej atje u deshke që me dalë bashkë me veprimtarët tjerë se ishte detyra që me dalë me vizitu popullatën e mbetur në çfarë gjendje osht', çka ju nevojitet. Dhe normalisht, nuk ish e lehtë me dalë se tash në atë aktivitet ja rrezikojshe shpinë edhe dikujt tjetër që ishte mbush me neve. Sepse tu i pa nevojtarët u deshke m'i njoftu organet e caktuara të bashkëvepronim çka me ju ndihmu, apo çka ju nevojitet, apo çka bohet.

Edhe faktikisht ishte ajo që në një mënyrë bënin që ndoshta të jem ajo që po mund të bëj diçka, sepse faktikisht kur fillun me hy, faktikisht pastaj këto forcat në Kosovë, qato ishin ato shkëndijat që neve na banën m'u gëzu, se nuk ishte e lehtë. Që ju thashë, kjo që kemi qëndru, shtëpia aty ka qenë gjatë fillimit të bombardimit dhe ata në një mënyrë i lajmërun qarqet tjera se na i kemi gati dyqind njerëz e tjerë këtu, për t'i marrë si, "Nëse ju gjuni këtu, ata, faktikisht dimë çka bojmë me ta". Edhe nuk ishte e lehtë ajo aty. Po që ju thashë, pastaj na heqën prej aty, shkumë, ato që ju thash që mos t'i përsëris.

**Anita Susuri:** E dita e shlirimit?

**Ajnishahe Azemi:** O si sot më kujtohet (buzëqesh), meqenëse ishim në Kodrën e Trimave, hyrja e forcave. Ato fytyra të gëzuara, ato lule, ata njerëz që hipshin mbi tanke e tjera. Tu i përshëndet ato forca, nuk më hiqen prej mendje. Dhe aty ato forca, dojshin me bisedu me forcat, po mendoj njerëzit e ndryshëm po ishte në pikëpyetje nevoja për angazhim për gjuhën angleze. Dhe Iliri dhe Nora, te dytë gjuhën angleze e dinin. Edhe nuk e di une, Ilirin s'e shifsha kërka, kur po ndëgjoj po ma bon njo afër, "O e pash Ilirin me ni tank, ata bisedojshin, bisedojke me ata, folke me ata tjerët". Se bisedojshin me do tjerë qytetarë edhe tash ai ju përkëthejke.

Në anën tjetër ata po thonë do, "Po kërkojnë përkthyes tjerët aty". Nora, "Nonë, une po shkoj" dhe shkonin në kohë të caktuar sa ishin aty, faktikisht për t'i ndihmu ata. Po kurrë nuk më hiqet prej mendjes ai gëzim i asaj popullate, ato fytyra të qeshura, ato përpjekje për m'i përshëndet në atë mënyrë qysh donin, qysh dinin edhe qysh mundnin ata. Me lule, me fjalë të mira, me përqaftime e tjera, ishte ajo që e bënte që për popullin po vijnë ditë më të mira. Po vjen liria e Kosovës dhe kontributi ynë po shpaguhet, i të gjithë atyre që kontribuan për me ardhë kjo ditë.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Anita Susuri:** Deshtët me folë edhe për angazhimin e pasluftës.

**Ajnishahe Azemi:** Po.

**Anita Susuri:** Nëse doni...

**Ajnishahe Azemi:** Angazhimi pas luftës ka qenë i një natyre tjetër. Prandaj edhe thashë të jetë e veçantë. Një natyre tjetër se nuk e dije, nuk e kishe atë frikën se vritesh, se vrahesh apo diçka tjetër, se duhet me përmend edhe ate. Nuk e kishe faktikisht mundësinë për realizimin e aktiviteteve sepse fillun institucionet të konsolidoheshin me ato shëndetësore apo tjerë që kishin nevojë. Dhe mundësitë thjesht për zhvillim të aktivitetit ishin ma të mira, ma të shumta për me mujt me kontribu. Osht' ni karakteristik për me tregu këtu që unë në atë kohë, se para luftës faktikisht kishin kërku një organizatë quhej "Medecins Du Monde" në atë kohë, kishin kërku se ku janë gra që përkrahin lëvizjen për me i ndihmu edhe që e kanë gjendjen ma të rënduar ekonomike.

Dhe ata para lufte kanë ardhë, i kom pasë në shtëpi, i drejton dikush te unë, thotë kështu, "Ajo punon me gra edhe osht' e kyçun në këto rrjedha ma së miri". Për mos me zgjat ma shumë me e hap faktikisht qendrën për punë psiko-sociale, "Se ka nevoj kjo popullatë e kësaj pjese dhe keni të zhvendosur shumë gjatë luftës". I fillum ato përgaditjet, i bomë ato përgaditjet edhe ishim tu i kërku lokalet ku me i bo që me punu me atë pjesë të qytetarëve edhe nevojtarëve. Mirëpo, ranë bombardimet e tjera e këto tjera, ata u tërhoqën shkunë. Edhe tash në ndërkohë pas lufte, une isha në shtëpi kur po e shoh që po troket dikush në derë, dal, kur p'e shoh qat' ekip të asaj organizate.

E thonë, "Hej, Ajnishah ki me ardhë prapë", "Ani, urdhnoni", "Me vazhdu aktivitetin për me i bo qato qendra atje". "Eh" thashë, "për ato unë e kom ni propozim", "Hajde bre, të ndëgjojmë?" Thashë, "Na tash ato qendra nuk po i bojmë këtu në Prishtinë, por po i bojmë në Drenas". "Pse?" "Se këtu sado-kudo kishe mundësi" se filloi sistemi shëndetësor në forma të ndryshme të organizohet edhe popullata filloi të zhvendoset. Pavarësisht, në kthimin nëpër shtëpitë e tyre e tjerë, domethonë filloi gjendja a, ata që ishin nevojtar kishin mundësi tjera me institucione apo diçka mrenda mundësive.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Ajnishahe Azemi:** Siç e thashë erdhën ata, qajo shoqata franceze "Medecins Du Mond", thonë, "Ajnishah, po dojna me vazhdu punën". Edhe thashë, "Une e kom ni propozim" dhe pastaj e dhashë edhe arsyetimin pse po e boj këtë propozim, e ndëgjun me shumë vëmendje. Thashë, "Do të shkojmë në Drenas". Faktikisht në mënyrë që, sepse atje popullata ka vuajt ma shumë, ka përjetu dhunë të formave, masakra të ndryshme, vrasje të mëdhaja. Jo, që s'kanë përjetu këtu. E popullata te ne edhe pse jemi në gjendje më të rënduar ekonomike dhe vështirësitë e tjera që ishin gjatë luftës e këto tjera, na kemi mundësi sado-kudo mrenda mundësive që institucionet e Republikës së Kosovës që po i ofrojnë t'i shfrytëzojmë. Ndërsa, atje t'i vendosim këto qendra.

Dhe shkumë bisedum atje me njerëzit, nuk po më kujtohet se kush kanë qenë ata njerëz në komunë atje dhe ju kërkum që kështu, kështu dhe në një mënyrë ata e pranun me shumë dashamirësi. Dhe atje i vendosëm ato qendra, kanë qenë, meqenëse ata lokacionin nuk kishin mundësi me siguru, ka qenë aty afër qendrës për punë sociale ni hapsinë e madhe e pashfrytëzume, si lloj livadhi e tjera. Dhe në

anën tjetër pak ma larg ishte edhe shkolla fillore që e dishin që aty janë të grumbulluar fëmijtë të cilët i kanë përjetu këto dhuna. Dhe e pamë të arsyshme dhe ishte e mundshme qendra e Drenasit sepse mund të frekuentohej edhe prej njerëzve nevojtarë që kanë këto probleme, edhe prej fshatrave të tjera.

Dhe aty i vendosën do tenda për me i zhvillu aktivitetet psiko-sociale, të cilat mendoj se kanë kontribuar mjaft. Këtu kisha dashtë me cekë që unë gjatë luftës nuk kom qenë, po pas luftës, në Poklekun e Ri, aty tu i zhvillu ato aktivitete, me shku në familjen e cila pësoi me vrasje të mëdhaja. Faktikisht dikun, nuk e di numrin e të vdekurëve, po shumë kanë qenë. Dhe kishin shpëtu pak njerëz aty. Dhe kur shkojmë me i pa atje, në Poklek të Ri, nuk është larg Drenasit, në vijë ajrore shumë afër, nëse shiqohet prej atij vendit ku ishin ato qendra dhe i vizitum ata. Dhe e dishim aty që ishte dhe një fëmi, një vajzë e cila kishte shpëtu falë gjindshmërisë nanës së saj, asaj masakre. Dhe ajo nuk fliste prej atëherë, nuk fliste prej atëherë.

Dhe kur na tregun si ishte bërë ai vend, ajo shtëpi, shkumb e hi, tu na tregu ata që se si i kanë marrë, si i kanë vra, si i kanë djeg pastaj për me hup gjurmë, çka kanë përjetu në atë vendin ku jetonin. Ishte shumë e randë. Por, meqenëse ishte pjesë e profesionit me veti përpos tjerash morëm edhe ni kukull. Dhe atë kukullën tonë e mbajmë gjithëherë me qëllim në dorë, që në një mënyrë apo një tjetër me mujt me tërhjekë vëmendjen asaj vajzës, mos po na reagon në një formë apo në një tjetër, ajo vajzë e vogël. Ka qenë ndoshta dy-tre vjeçe, ndoshta gabo, po shumë e vogël. Edhe tu lujt në ndërkohë, nganjherë e bojsha me shenjë që po ja jap po vazhdojsha me folë, në një formë me pasë ndikim se ndoshta drejtëpërdrejtë me punu se, nuk ishte ajo që donte ndonjë bashkëpunim.

Dhe tash për mos me zgjat, ata na tregun për ato vujtje, të cilat ndikonin shumë edhe në neve edhe ndoshta nevoja për përkrahjen që e tregonin edhe në qat' gjendje sa ishin gëzu, na e tregun fakturën që kanë ble bimë. Dhe në ndërkohë në një mënyrë ja tërheqi ajo kukulla vërejtjen asaj vajzës dhe veç kur ka thonë, "Ama!" E në atë moment ata janë gëzu shumë, "Po fliska, nuk e paska humb të folurit", a din? Edhe ai moment shumë më kujtohet, shumë emocionus, shumë i vështirë edhe për familjen edhe për tjerë se përpos atyre vujtjeve të tjera, se edhe një fëmijë ju ka mbetë në atë gjendje. Po ishte ai momenti kur ata u gëzun shumë.

Na ndërkohë asaj familje ni vajzë ja u... se ata pastaj aty faktikisht me vazhdu me shku nëpër ato qendra sociale se kishte nevoj se çka kishin humb ishin të mëdhaja. Dhe kështu që, edhe ai rast më ka prek shumë, po jom mundu në atë mënyrë me dhonë ni kontribut sado-kudo me i vizitu dhe pastaj me i njoftu. Prej aty shkumë i njoftum institucionet e komunës aty të Dragashit, "E kështu, kështu, ata ishin kët' gjendje, kët' gjendje, kët' gjendje". Pastaj në një mënyrë që të përkrahet ajo familje në mënyrë institucionale në forma të ndryshme. E kështu që, besoj që ajo ishte një shpresë se çfarë nevojash kishte populli jonë në atë kohë pas lufte, në çfarë gjendje ishte, çfarë përkrahje ka, për çfarë përkrahje faktikisht ka nevoj.

E tjetër që është angazhimi, pra e karakterizon, i pas luftës, angazhimin tim, angazhimin në Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe në Forumin e Grusë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Prej atëherë, thashë në të gjitha format e organizimeve qoftë në nivel, qoftë në degë e tjera. Në organizimin e

zgjedhjeve, në forma të ndryshme të përkrahjes së popullatës sa kishte nevojë, mrenda mundësive që kemi dhanë. Po këtu desha të theksoj se prej vitit 2002 për çka e falenderoj elektoratin ma besun që tash ti prezentoj interesat e tyre faktikisht para institucioneve. Dhe ku isha kandidat e Lidhjes Demokratike të Kosovës për këshilltare, më zgjodhën që me votat e tyre pastaj edhe në tri mandate tjera, domethonë tri mandate më besun që me votat e tyre... nuk kom hy me kuotë asnjëherë. Por me votën e elektoratit, unë isha aty këshilltare, siç thashë, tre mandate, 15 vite.

Ajo ishte për mu, për angazhimin tim, e tjera, shpërblim se elektorati po më beson që unë të prezentoj interesat e tyre. Dhe jom mundu me shumë përkushtim të bëj atë që ka qenë mendoj se ma e mira. Shpresoj ta kem bërë ma të mirën, por nëse kom bo naj lëshim kërkoj falje, jo që ndoshta e kom vërejtë që është lëshim ajo që e kom bo. Dhe ajo pastaj në strukturat e LDK-së, në arsim siç ju thashë, në gjimnazin "Xhevdet Doda", meqenëse këto angazhimet tjera. Por edhe ka qenë vazhdimësi te unë edhe kisha dashtë me theksu si një aktivitet, që e thashë përpos aktiviteteve humanitare, unë isha aktiviste e çështjes së aftësisë së kufizuar, prej vitit '94.

Fillimisht në, u angazhova në Handikos, tu e pa gjendjen e rënduar, përpos gjendjes së rënduar e tjera, që e ishte sikurse krejt popullata e Kosovës, kjo kategori dhe familjet e tyre. Tu e pa se janë të lanë pas dore, dhe nevojat e tyre specifike që ata e kanë për me dhonë përkrahje. Dhe faktikisht mas luftime, faktikisht isha e rregullt aty dhe pastaj kohë pas kohe kom ndihmu. Edhe me organizimin faktikisht, me interesimin e udhëheqësit të Handikos, Salit Ferizit, faktikisht e formuam një shoqatë që i përkrahin prindërit e personave me aftësi të kufizuar. Vetëm qëllimi ishte që të ndihmohet kjo popullatë sepse... Edhe të mundohemi në forma të ndryshme, të llojshmëri të institucioneve të Kosovës se edhe kjo kategori e popullatës është ajo që e meriton përkrahje.

Pastaj në Sindrom Down Kosova, në dy mandate. Mendoj se kjo kategori e popullatës osht' e lonë pas dore edhe tash institucionet e Kosovës nuk kanë bërë as para as pas luftime atë që e meritojnë ata. Është karakteristike me përmend se janë aprovu ligje në mënyrë selektive, për disa kategori, persona me aftësi të kufizuar, respekt për ata që e kanë ndihmu këtë kategori. Por ku janë nevojat e kategorive të tjera? Ata e aprovun faktikisht, ligjin për përkrahjen e të verbërëve, ligjin për përkrahjen e paraplegjikëve, të cilët, të gjitha këto i meritojnë këta, unë po flas se pse u lanë të tjerët. Ka pasë, ka fillu është aprovu që është i pazbatueshëm ligji për aftësimin dhe riaftësimin e personave me aftësi të kufizuar për të cilin nuk gjen zbatim.

Sepse aty faktikisht është e kërkuar me rregullore dhe me akte tjera normative atje është e rregulluar ajo se si duhet çdo organizatë ku ka 50 punëtorë ta propozojnë një person me aftësi të kufizume. Kjo nuk zbatohet në raste të caktuara edhe pse osht' ma mirë gjendja se që ka qenë, po jo ajo qysh respektohet. Osht' edhe një tjetër se ligji për personat zyrtarë, për punësimin zyrtar atje e pengon faktikisht mundësinë e realizimit të kësaj, pse? Se këta dihet që janë persona me aftësi të kufizuara dhe aty në ato raste të konkurimit, ata aty nuk kanë asnjë rrethanë lehtësuese, personat me aftësi të kufizume që të mund të konkurojnë për një vend pune.

Kuptohet nuk jam për atë që pa meritë edhe një vend që nuk e zotnojnë, diçka ni aftësi të caktuar që nuk e zotnojnë, të mos i jipet vendi i punës, po ti jipet aty ku ai mundet me bë. Mundet ndoshta mos



me ecë, po mundet me qenë me karrocë ndoshta afër tavolinës, me punu se e ka mendjen e shnosh. Kemi pasë edhe nxansa, kom pasë edhe njerëz të tjerë që kanë qenë shumë të mençur që kanë mujt me kry punë të ndryshme. Atëherë, pse nuk u bo diçka që, ndonji rrethanë ndoshta lehtësuese aty që nuk e damton kryerjen e përgjegjësive të cilat mund. Duhet t'i kryej ai person.

Edhe kjo ka pasë ni përpjekje faktikisht për me bo ni ligj gjithëpërfshirës, i cili do të përfshinte faktikisht përkrahjen e gjithë personave, po ai nuk ka mrrri me u aprovu. Osh t' i përkrahur për shembull, është i përkrahur edhe ligji për përkrahjen e familjes me persona me aftësi të kufizuar deri në moshën 18 vjeçare. Po ajo që përkrahet edhe personat që i gëzojnë 75 euro, apo varësisht njiqind euro apo këto tjerat, osht' diçka që faktikisht nuk i plotësojnë nevojat e tyre për çfarë kanë ata.

Pra, në mënyrë permanente kanë qenë këta persona që mos me thonë barrë e familjes, po të përkrahun vetëm me atë që mund t'ju ofroj familja. Edhe pse ju thashë, ka pasë aprovime të ligjeve e tjera, dhe ka përparime të shumta edhe në shkollimin e tyre edhe në përfshirjen e tyre nëpër shkolla. Ka shkolla që kanë fillu, po jo sa ata kanë nevoj dhe në numrin sa jonë dhe sa kanë nevoj për përkrahje. Sot, për shembull dikush që ka person me aftësi të kufizuar mbetet, ndoshta duhet me lëshu punën, për arsye se s'ka ku me çu për m'u kujdesë dikush dhe i kërkohet me gjetë dikun m'u kujdes për te, e kështu me radhë. Pra, kanë përkrahje ma të madhe se para luftës, po jo përkrahjen e merituar, dhe jo përkrahjen që ju nevojitet.

**Anita Susuri:** Zonja Azemi, nëse keni edhe diçka me shtu për fund, nëse keni harru diçka me përmend?

**Ajnishahe Azemi:** Me harru sigurisht që kom harru shumë (buzëqesh), sigurisht se shumë. Se ndoshta në këtë rast janë 20 vite që kanë kalu ose ma shumë, po mendoj në luftë, po edhe para lufte po mendoj vitet e '90-ta, sigurisht se kom harru. Më vjen keq nëse nuk mrrij me përmend atë që e ka meritu edhe me siguri ka meritu se kanë sakrifiku çdo gja. Po në këtë rast nuk munda t'i përmend. Po harrova t'ju them, që ju thashë edhe dy kuvende të Forumit të Grusë, nëse më lejoni, në mënyrë shumë të shkurt?

**Anita Susuri:** Po.

**Ajnishahe Azemi:** Në Kuvendin e Parë të Forumit të Gruas dhe faktikisht Kuvendin e Dytë, në Kuvendin e Parë siç ju thashë e kishim parapa me organizu me 24 gusht në Shkollën e Medresës. Mirëpo, morëm informatën në ndërkohë se aty rrezikohemi edhe përkundër asaj se drejtorja e asaj shkolle ka pranë, megjithatë dhe u deshtë me menu shumë shpejt ndrrimin e lokacionit. Se ftesat ishin bo për Kuvend, ishin dërgu edhe grave të Shiprisë, të Maqedonisë, shqiptarë po flasim, Preshevës, Bujanovcit, Malit të Zi, të cilat e kishin lajmëru ardhjen. Dhe, çfarë të bëjmë? Biseduam me shkolla të ndryshme si "Emin Duraku", pastaj "Zenel Hajdini" dhe "Asim Vokshi". Tash në një mënyrë me mendu që çdonjërit m'i thonë që, "Na po vijmë këtu, përgadite sallën".

Po faktikisht vendosëm në fund, në momentin e fundit për me mbajt në "Asim Vokshi". Për arsye se ishin tri shkolla, në mënyrë që të mendohet ndoshta se po e mbajmë këtu, apo këtu, apo këtu deri sa të vendosin na nashta mujna me kry punë në nji shkollë tjetër. Dhe, siç ju thashë ato ftesat, për atë Kuvend është karakteristike edhe kjo, i kemi bërë për atë Kuvend për gratë dhe delegacionet e

ndryshme, i kemi përgaditë në studion të cilën e udhëheq Arsim Shala, fëmijë i të burgosurit politik. Aty siguronte ekzistencën e familjes që edhe aty me gjetë që po përgaditë për një organizim politik ishte ndoshta edhe ndërprerja e mundësisë për sigurimin e ekzistencës së asaj familje. Por, megjithatë ajo nuk ndodhi dhe ata pa pritesë e bënë.

Pastaj materiali që u përgaditë që u deshke me ju dhonë këtu kësaj, delegacioni dhe pjesëmarrësve aty, i ka përgadit Flora [Brovina] me të tjerët, jo unë. Por, më thirri tha se, “Këto materiale të përgaditura duhet” tha, “m’i shumëzua për m’i shpërnda”. Dhe ato i kom marrë, tash unë veturë kurrë s’kom pasë personale (buzëqesh), tash djali e ka, djali i madh. Po vetëm në kambë, edhe ish ni frikë se ato materiale kur i mora, tash po më nalin, po nuk është në pyetje po më nalin, se unë veç isha identifikua me çështjen dhe nuk ishte ajo që po kallxohem trime apo diçka tjetër, po e njihja si përgjegjësi me vazhdu.

Dhe kom shku afër komunës, që është një inxhinjeri, një ndërtesë tash po më duket nuk punohet kurgjo, në katin e dytë aty. Aty e kemi dërgu, se veç ishte biseduar, nuk e di kush kanë qenë ata, nuk e di. Dhe ato që kërkun sa, në çfarë përmasa me i bo, dhe i përgaditën, i morën faktikisht i vendosën aty, faktikisht ku vendosën për shkollën, “Asim Vokshi”. Nejse, na fillum me mbajt Kuvendin, ma përpara faktikisht u lajmërun delegacionet dhe po që janë ardhë u vendosën diku nëpër fshatra e tjera atje. Se nuk mujshin fort me lajmëru që janë këtu, po megjithatë e dinim. Po edhe delegatet kishin lajmëru që vijnë. Të nesërmen e fillum atë Kuvend dhe unë aty pata besimin e atyre grave që të jem kryetare e komisionit zgjedhor, në mënyrë që aty t’i numërojmë votat.

Ato e kanë organizuar në mënyrë të rregullt që të votohen, pra kandidatet e përzgjedhura për kryesi në Forum të Gruas, se ishte Kuvendi i Parë. Dhe ato... bashkë me shoqe të tjera, tri ishim, edhe që na ndoqi Pranvera Rugova dhe unë isha kryetare, ato më thanë që, “Do të jesh, se Ajnishah ndoshta me ndodh diçka ti e din” ma besun atë dhe e mora. Nuk është e lehtë, se e disha që janë lajmru që po mbahen punimet e Kuvendit dhe do t’i udhëheqim mekanizmat në atë kohë dhe me lajmëru, me lajmëru ato rezultate nuk ishte e lehtë. Por ajo faktikisht nuk ndodhi i lajmërova rezultatet, e tjera. Aty pat fitu Flora Brovina, pastaj tjerat që ajo sigurisht i ka lajmëru pse dhe si. Faktikisht angazhimin e saj e ka vazhdu jashtë Lidhjes Demokratike të Kosovës, po aty ka qenë kjo.

E tjetër që ka qenë, Kuvendi i Dytë, unë i theksova këto dy kuvende se kanë qenë në kohë të pakohë të organizume. Kohë kur ishte gjendja shumë e rënduar politike e tjera. Dhe në Samadraxhë, kryesia e Forumit të Gruas, unë në atë kohë nuk kom qenë në kryesi po kom qenë antare e kryesisë së zgjeruar. Meqenëse, faktikisht u zgjedha si kryetare e Forumit të Gruas të degës së parë, biseduam me kryesinë e Forumit të Gruas të Lidhjes Demokratike të Kosovës të Suharekës, të cilën e udhëheqte Samie Zeqiraj, dhe kryesinë e LDK-së, të Suharekës. Dhe për përkrahje që ta organizojmë Kuvendin atje. Qëllimi i shkuarjes atje ishte ajo që faktikisht ju ikë pengesave të ndryshme që mund të dalin në Prishtinë.

Pse e theksova këtë? Atje pamë kur shkum, ni pritje shumë të mirë që na banë ata, ajo degë, ai Forum. Që neve na thirrën me dy autobusa, gra dhe vajza shkumë para se të mbahet Kuvendi, qëndrum atë natë, na vendosën nëpër shtëpi të ndryshme. Ata njerëz si na pritën, si na faktikisht ndihmuan që të

shkojmë pastaj se ishte një fshat i largët Samadraxha atje, me veturat e tyre e tjera. Si atje kur shkum, ni përkrahje, shumë njerëz, shumë kishin dalë, shumë vendas aty. Që në një mënyrë ata, dukej kjo, ishte e saktë se këta kanë dalë në një mënyrë apo në një tjetër për përkrahje të punës tonë, por edhe nëse ne pengohemi me na dalë në mbrojtje. Po edhe ni tjetër ishte ajo se si ata ishin organizuar aq mirë për të gjitha neve, me siguru ushqime, nuk e di si quhet ajo gru, tash e kom në mendje, po nuk ka kohë të gjatë që s'e kom pa, po s'po më kujtohet për momentin emri.

Se si ishin organizu me përgaditjen e ushqimit, si na shërbenin, si në një mënyrë na mbanin, si me thonë, "Ja që këtu ne jemi" dhe "Ju do ta mbani derisa jemi ne këtu". Edhe atë natë na kanë kthy, na kanë mbajtur, nuk na kanë lëshu me dy autobusa. Jo të gjitha grave, po dy autobusa e di që kemi shku prej këtu, prej Prishtinës, po kemi qenë jo veç të Prishtinës, po edhe pjesëve tjera. Na kanë mbajtur edhe atë natë, na kanë organizu edhe njëfarë ahengu tjetër se na mbajtëm diçka institucionale, mbajtëm diçka se qëllimi ishte edhe me tregu aty se gjithçka organizojmë në mënyrë institucionale, në mënyrë të mirëfilltë ashtu siç duhet, e tjerë.

**Anita Susuri:** Nëse nuk keni edhe diçka me shtu e kishim përmbyll...

**Ajnishahe Azemi:** Më vjen keq nëse nuk e kom përmend e theksova që sa herë, kontributin e çdokujt. Respekt për kontributin e çdokujt që ka dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Faleminderit prej juve që më keni thirrë në intervistë, jom mundu me atë që munda ta përmend, po prapë jam e bindur që nuk i kom përmend të gjithë. As kontributin tim, as kontributin e gjithë bashkëveprimtarëve dhe bashkëveprimtareve, që këto... më lejoni vetëm edhe qeta t'i përmendi, se kemi pasë pas luftës aktiviste të shumta që kanë qenë. Po flas këtu, do të ndalem vetëm në degën e parë, për arsye se aty isha kryetare e ndjej vetën si ma përgjegjëse, deri në 2016, siç ju thashë.

Po i përmendi shumë aktiviste të cilat ishin për shembull që kanë ndihmu, po edhe shumë e shumë, jo vetëm ato që i përmenda, po edhe shumë e shumë tjera na kanë ndihmu se na nuk kishim mujt kurgjo me bo pa përkrahjen e tyre, me përkrahjen e degës. Si Fatushe Dragushën, pastaj ta përmendi Vjollca Beqirin, Afërdita Dumnicën, ta përmendi Naime Osmanin, Bedrijen, Fitoren, e shumë, e shumë të tjera që kontribuan faktikisht në angazhimin e Forumit të Gruas dhe kontribuan me të gjitha ato aktivitete që Forumi i Gruas i bante në forma të ndryshme, si në organizimin e zgjedhjeve dhe përkrahjen e nevojtarëve të ndryshëm në raste të caktuara, por tash kjo një formë ma e lehtësuar.

**Anita Susuri:** Faleminderit pra edhe juve zonja Azemi, për të gjitha!

**Ajnishahe Azemi:** Faleminderit edhe për ftesën, respekt!